



GAZETA ZYRTARE

E KRAHINËS SOCIALISTE AUTONOME TË KOSOVËS

Nr. 10

Prishtinë, 27 mars 1987

VITI XLII

Në bazë të nenit 54 të Ligjit për ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit mbi pyjet („Gazeta zyrtare e KSAK”, nr. 46/86), Komisioni legjislativo-juridik i Kuvendit të Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 20 shkurt 1986 përcaktoi tekstin e spastruar të Ligjit mbi pyjet.

Teksti i spastruar i Ligjit mbi pyjet përfshin Ligjin mbi pyjet („Gazeta zyrtare e KSAK”, nr. 10/77) dhe Ligjin për ndryshimet dhe plotësimet e ligjit mbi pyjet („Gazeta zyrtare e KSAK”, nr. 46/86), në të cilat është shënuar koha e hyrjes së tyre në fuqi.

KK Nr. 112-981/86
Prishtinë, 20 janar 1987

Kryetari i
Komisionit Legjislativo-Juridik
Rade Zvicer, d. v.

LIGJI MBI PYJET

(Teksti i spastruar)

I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

Me këtë ligj përcaktohet mënyra e udhëheqjes dhe e qeverisjes së pyjeve dhe tokave pyjore, në qoftë se për disa pyje, me dispozitat të veçantë, nuk është caktuar ndryshe.

Pyjet dhe tokat pyjore si pasuri me interes të përgjithshëm për shkak të funksioneve të veta me vlerë të përgjithshme, gëzojnë mbrojtje të veçantë të përcaktuar me këtë ligj dhe dispozitat e nxjerra në bazë të tij.

Neni 2

Pyll konsiderohet toka e mbuluar me drunj pyjorë, pa marrë parasysh se cila kulturë është regjistruar në kadastër.

Tokë pyjore konsiderohet toka e cila për shkak të vetive të veta natyrore dhe kushteve ekonomike më së miri shfrytëzohet kur në të kultivohen pyjet, apo nëse me planin hapësinor është destinuar për pyje.

Pyje, konform këtij ligji, nuk konsiderohen buleverdet, fidanishtet pyjore, zonat mbrojtëse, parqet në vendbanime, si dhe grupet e drunjve pyjorë në sipërfaqe gjer 5 ari.

Në rast kontesti se a konsiderohet pyll ndonjë tokë e mbuluar me drunj pyjorë, përkatësisht e konsiderohet ndonjë tokë si tokë pyjore, vendos Këshilli Ekzekutiv i Kuvendit të Komunës.

Neni 3

Pyjet duhet të mirëmbahen, përtrihen dhe të shfrytëzohen ashtu që të ruhet vlera e tyre, të sigurohet qëndrueshmëria dhe shtimi i përhershëm i rendimenteve, si dhe funksionet e tyre me dobi të

Vëllimi i kultivimit të pyjeve duhet të jetë në harmoni me vëllimin e shfrytëzimit të pyjeve.

Neni 4

Sipas destinimit pyjet janë: ekonomike, mbrojtëse dhe me destinim të veçantë.

Pyjet ekonomike shërbejnë, në rend të parë, për prodhimin e drurit dhe prodhimeve tjera pyjore.

Pyjet mbrojtëse shërbejnë, në rend të parë, si mbrojtje e objekteve ekonomike dhe objekteve tjera, vendbanimeve, tokës, rrjedhave ujore dhe pasurive tjera.

Pyje me destinim të veçantë janë pyjet që paraqesin veçori të veçantë natyror ose kanë rëndësi të veçantë shkencore apo industriale (parqet nacionale dhe rezervatet e veçarive dhe bukurive natyrore), pyjet e destinuar për piknike, kërkime shkencore, mësimi për nevojat e mbrojtjes popullore dhe për nevojat tjera të përcaktuara me ligj.

Neni 5

Qeverisja e pyjeve është veprimtari me interes të posaçëm shoqëror.

Synimet e përgjithshme të qeverisjes së pyjeve përcaktohen me programin e zhvillimit të pylltarisë, të cilin e nxjerr Kuvendi i KSA të Kosovës.

Neni 6

Me qëllim të sigurimit të qeverisjes racionale të pyjeve, realizimit të mjeteve për reproduksionin e zgjeruar të pyjeve dhe interesave tjera të përgjithshme formohen rajonet ekonomike pyjore.

Neni 7

Qarkullimi i pyjeve dhe i tokave pyjore bëhet sipas dispoziteve mbi qarkullimin e pasurisë së paluajtshme, nëse me ligj nuk është caktuar ndryshe.

Marrja me qira e pyjeve dhe e tokave pyjore bëhet sipas dispozitave mbi qiradhënien e tokës bujqësore, nëse me këtë ligj nuk është caktuar ndryshe.

Neni 8

Për pyllin e pronësisë shoqërore nuk mund të fitohet e drejta pronësore duke e mbajtur.

Neni 9

Pyjet e pronësisë shoqërore, si dhe pyjet në të cilat ekziston e drejta e pronësisë në kuadër të rajonit ekonomiko-pyjor qeverisen sipas bazës ekonomike pyjore dhe bazës ekonomike pyjore të njësisë ekonomike, nëse me këtë ligj nuk është caktuar ndryshe.

Pyjet e pronësisë shoqërore jashtë rajonit ekonomiko-pyjor, qeverisen sipas bazës ekonomiko-pyjore të njësisë ekonomike.

Pyjet me destinim të posaçëm nga neni 4 alineja 4 të këtij ligji, qeverisen në bazë të bazës ekonomike-pyjore të njësisë ekonomike.

Neni 10

Me qëllim të përparimit të pylltarisë dhe realizimit të nevojave dhe interesave të përbashkëta në riprodhimin e zgjëruar të pyjeve, me këtë ligj themelohet Fondi për riprodhimin e zgjëruar të pyjeve të Kosovës (në tekstin e mëtejme: Fondi).

Punët e fondit të përcaktuara me këtë ligj janë punë me interes të posaçëm shoqëror.

Neni 11

Pyjet dhe tokën pyjore (në tekstin e mëtejme: pyjet) në pronësinë shoqërore i qeverisin organizatat e punës së bashkuar nga lëmi i pylltarisë (në tekstin e mëtejme: organizatat).

Përfshatimisht disa pyje nga alineja 1 e këtij neni jashtë rajonit ekonomik-pyjo mund t'i qeverisë organizata tjetër e punës së bashkuar ose personi tjetër juridik-shoqëror, nëse i plotësojnë kushtet e përcaktuara me këtë ligj.

Pyjet në pronësinë shoqërore kanë statusin e mjeteve themelore.

II. RAJONET EKONOMIKE-PYJORE

Neni 12

Rajoni ekonomik-pyjo formohet sipas kushteve natyrore-ekonomike dhe kushteve tjera të cilat paraqesin tërësinë unike natyrore dhe ekonomike e cila siguron kushtet për realizimin e përhershëm të mjeteve për riprodhimin e thjeshtë dhe pjesërisht të riprodhimit të zgjëruar të pyjeve.

Rajoni ekonomik pyjo përfshin pyjet në pronësinë shoqërore, si dhe pyjet në të cilat ekziston e drejta e pronësisë.

Përfshatimisht nga alineja 1 e këtij neni formohet rajoni i veçantë ekonomik-pyjo i pyjeve të degraduara, veprimtaria e të cilave është kryesisht kultivimi dhe mbrojtja e pyjeve, si dhe shfrytëzimi i funksioneve të tyre me rëndësi të përgjithshme dhe të cilat nuk realizojnë mjete të mjaftueshme për riprodhimin e thjeshtë të pyjeve.

Në rajonin ekonomik-pyjo nuk përfshihen pyjet me destinim të veçantë dhe pyjet më pak të izoluar me të cilat qeverisin organizatat tjera të punës së bashkuar.

Neni 13

Në territorin e KSA të Kosovës formohen këto rajone ekonomike-pyjo:

1. Të Pomoravljës,
2. Të Nerodimes-Lepencit,
3. Të Sharrit-Podrimës,
4. Të Bjeshkëve të Nemuna — Bistricës,
5. Ibër-Llapit dhe
6. Kosovës-Drenicës, rajoni i pyjeve të ulta dhe të degraduara.

Pyjet të cilat janë të përfshira me disa rajone ekonomike-pyjo nga alineja 1 e këtij neni janë të regjistruara në regjistrin e pyjeve të rajoneve ekonomike-pyjo dhe të rejoneve ekonomike-pyjo të pyjeve të ulta dhe të degraduara, të cilat publikohen me këtë ligj dhe janë pjesë përbërëse të tij.

Neni 14

Me qëllim të qeverisjes me pyjet në pronësinë shoqërore të përfshira me rajonin ekonomik-pyjo, themelohet organizata punuese e pylltarisë.

Funëtorët kanë të drejtë dhe obligim që një pjesë të organizatës punuese ta organizojnë si organizatë themelore të punës së bashkuar, nën kushtet e përcaktuara me Ligjin mbi punën e bashkuar, duke pasur kujdes për organizimin racional të qeverisjes dhe të arsyeshmërisë ekonomike.

Organizata nga alineja 1 e këtij neni mund të qeverisë me pyjet në pronësinë shoqërore të përfshira me dy ose më shumë rajone ekonomike-pyjo.

Neni 15

Nëse në rajonin ekonomik-pyjo në organizatën punuese e cila i shfrytëzon pyjet në pronësinë sho-

qërore formohen më shumë organizata themelore të punës së bashkuar këto organizata me marrëveshje vetëqeverisëse rregullojnë të drejtat reciproke, obligimet dhe përgjegjësitë në marrjen e masave në përkëmbje të shfrytëzimit dhe të përparimit të pyjeve të përcaktuara me bazën e përgjithshme ekonomike-pyjo, në bazat ekonomike pyjore të njësisë ekonomike dhe me programet e qeverisjes së pyjeve në të cilat ekziston e drejta e pronësisë.

Me marrëveshjen vetëqeverisëse nga alineja 1 e këtij neni rregullohen veçanërisht: marrëdhëniet reciproke të cilat janë me interes të përbashkët për zbatimin e qëllimeve dhe të detyrave të parapara në bazën e përgjithshme ekonomike-pyjo, bazën ekonomike-pyjo të njësisë ekonomike dhe programeve të qeverisjes me pyjet në përkëmbje të mirëmbajtjes, përfitjes dhe shfrytëzimit të pyjeve të atij rajoni ekonomik-pyjo, masat të cilat do të ndërmerren bashkarisht me qëllim të ruajtjes së vlerës së pyjeve sigurimit të qëndrueshmërisë dhe shtimit të përhershëm të rritjes dhe të rendimenteve, si dhe të sigurimit të mjeteve për realizimin e këtyre masave.

III. PYJET NË TË CILAT EKZISTON E DREJTA E PRONËSISË

Neni 16

Pyjet në të cilat ekziston e drejta e pronësisë i qeverisin pronarët e këtyre pyjeve nën mbikëqyrjen e kuvendit të komunës, në bazë të programit të qeverisjes (më tutje: Programi i qeverisjes).

Pronarët e pyjeve mund të bashkojnë punën e vet dhe pyjet me marrëdhënie të bashkëpunimit të përhershëm me organizatën punuese dhe vetë ose me punëtorët e asaj organizate të organizojnë organizatën themelore të kooperuesve në përbërje të asaj organizate për qeverisjen e pyjeve në të cilat ekziston e drejta e pronësisë.

Në bazë të vendimit mbi organizimin e organizatës themelore të kooperuesve pronarët e pyjeve vetë ose së bashku me punëtorët nga alineja 2 e këtij neni lidhin marrëveshjen vetëqeverisëse me të cilën përcaktojnë kushtet dhe mënyrën e bashkimit dhe të drejtat, obligimet dhe përgjegjësitë reciproke.

Pronarët e pyjeve janë të obliguar që të sigurojnë riprodhimin e thjeshtë biologjik të pyjeve në mënyrën e përcaktuar me këtë ligj.

Në programin e qeverisjes i cili nxirret për një ose më shumë komuna kadastrale ose për tërë territorin e komunës, në kuadër të rajoneve ekonomike-pyjo për kohën prej dhjetë vjetësh kalendari paraqitet gjendja e pyjeve dhe caktohen qëllimet e qeverisjes, lloji dhe vëllimi i punëve në kultivim dhe shfrytëzimin e pyjeve, si dhe masat dhe mjetet për arritjen e qëllimeve të qeverisjes.

Pasqyra e gjendjes së pyjeve duhet të përbajë të dhënet mbi sipërfaqen, rezervat e drurit dhe shtimin e pyjeve sipas llojeve të drunjve, formës së kultivimit, strukturën e vjetërsisë, respektivisht strukturën e trashësisë së drunjve, sipas parcelave dhe në tërësi.

Programin e qeverisjes e nxjerr organizata themelore e kooperuesëve, përkatësisht derisa të bëhet organizimi i saj kuvendi i komunës.

Programin nga alineja 7 të këtij neni e vërteton kuvendi i komunës.

Shpenzimet e hartimit të programit të qeverisjes i heqin pronarët e pyjeve, të cilat kuvendi i komunës i shpërndan në pronarët e pyjeve proporcionalisht me sipërfaqen dhe shkallën e ruajtjes së pyjeve dhe llojin e drunjve.

Pagesa e shpenzimeve nga alineja 9 e këtij neni nëse këto nuk i kompenson brenda afatit të caktuar pronari i pyjeve, bëhet sipas dispozitave që vlejn për pagesën e tatimit nga qytetarët.

Neni 17

Kuvendi i komunës mund të marrë përsipër kujdesin mbi përpërimin e pyjeve në të cilat ekziston e drejta e pronësisë.

Kuvendi i komunës i cakton pyjet nga alineja 1 e këtij neni për të cilat do të kujdeset, llojin dhe vëllimin e masave të përpërimin, si dhe lartësinë e shpërblimit sipas vlerës së drurit mesatar në cung dhe mënyrën e pagimit të shpërblimit për kujdesin e marrë përsipër mbi përpërimin e këtyre pyjeve.

Në qoftë se mbi përpërimin e pyjeve nga alineja 2 e këtij neni kujdeset kuvendi i komunës, pronarët e këtyre pyjeve e kanë për detyrë t'ia kompensojnë komunës shpenzimet e përpërimin të pyjeve të tyre.

Mjetet e shpërblimit mund të shfrytëzohen vetëm për përpërimin e pyjeve në të cilat ekziston e drejta e pronësisë në bazë të programit të qeverisjes.

Mjetet e shpërblimit mbahen në llogari të vëçantë.

Neni 18

Kuvendi i komunës punët e shënjimit, damkosjes së drunjve të prerë, lëshuarjes së fletëpërcjellësve, kontrollimin e qarkullimit të prodhimeve pyjore dhe mbrojtjen e pyjeve nga sëmundjet dhe dëmtuesit bimorë në pyjet në të cilat ekziston e drejta e pronësisë i bartin në organizatat të cilat qeverisin me pyjet në pronësinë shoqërore, në kuadër të rajonit ekonomik — pyjor.

Shpenzimet e kryerjes së punëve nga alineja 1 e këtij neni paguhen nga butxheti i komunës.

Neni 19

Për përpërimin e pyjeve në të cilat ekziston e drejta e pronësisë kujdeset organizata e punës së bashkuar e cila qeveris me rajonin ekonomik — pyjor.

Organizatat e punës së bashkuar, në kuadër të rajonit ekonomik — pyjor, janë të obliguar që të organizojnë shërbimin përkatës profesional për zbatimin e punëve nga ky nen, si dhe punët nga neni 18, 20 dhe 33 të këtij ligji.

IV. QEVERISJA E PYJEVE

Neni 20

Qeverisja e pyjeve përfshin sidomos:

1. Punët e riprodhimit të thjeshtë dhe të zgjeruar biologjik të pyjeve.

Punë të riprodhimit të thjeshtë biologjik të pyjeve nënkuptohen:

a) përgatitjet e vendit për përtrritjen natyrore të përbërjeve të parapara për përtrritjen natyrore në periudhën për të cilën është nxjerrë baza ekonomike — pyjore e njësisë ekonomike, përkatësisht programi për qeverisjen e pyjeve,

b) plotësimi, kultivimi dhe pastrimi i të gjitha përbërjeve që kanë prejardhje prej farës deri në moshën 20-vjeçare dhe të trungjeve deri në moshën 10-vjeçare, kurse në përbërjet e tjera të ndryshme me prejardhje prej fare të cilat qeverisin në mënyrë grupore, deri në moshën 20-vjeçare të grupit, pastaj rrallimi i përbërjeve deri në moshën 1/3 e vjetëve, kurse tek ato më të vjetër, nëse kjo është e nevojshme me qëllim të kultivimit,

c) pyllëzimi i sipërfaqeve të hapura pas prerjeve të plota të trungjeve të reja të krijuara dhe resurksioni i përbërjeve të degraduara të parapara me bazën ekonomike-pyjore të njësisë ekonomike, përkatësisht me programin e qeverisjes së pyjeve,

d) masat që ndërmarrën për mbrojtjen e pyjeve nga sëmundjet dhe dëmtuesit e bimëve dhe nga zjarri,

e) ruajtja e pyjeve nga veprimet e padrejta dhe shfrytëzimi,

f) hartimi i bazave ekonomike-pyjore, programeve planeve dhe revidimi i tyre.

Riprodhim të zgjeruar biologjik të pyjeve nënkuptohen:

a) punët e rikonstruktimit dhe meliorizimit e pyjeve të degraduara, të shkurrave dhe të kaqubave,

b) punimet në pyllëzimin e sipërfaqeve të zhveshura pyjore dhe të sipërfaqeve tjera që duhet të pyllëzohen,

c) punimet në ngritjen e fidanishteve intensive të llojeve të drunjve që rriten shpejtë,

d) ruajtja e pyjeve nga veprimet e padrejta dhe shfrytëzimi, në lartësi prej 50% të shpenzimeve të ruajtjes.

2. Punimet në shfrytëzimin e pyjeve dhe të tokës pyjore të fidaneve dhe të produkteve pyjore, të dorës së dytë (frutet, bimët mjekuese, humusit, myshkut etj.), nxjerrja e rërës, gurëve, zhavorrit dhe transportimi i produkteve pyjore.

3. Ndërtimi dhe mirëmbajtja e rrugëve pyjore, si dhe e objekteve të tjera me qëllim të qeverisjes së pyjeve.

1. Bazat e qeverisjes së pyjeve

Neni 21

Baza e përgjithshme ekonomiko-pyjore nxirret për të gjitha pyjet e përfshira në rajonin ekonomik — pyjor.

Me bazën e përgjithshme ekonomiko-pyjore caktohen synimet themelore dhe qëllimet e qeverisjes së pyjeve në pajtim me kushtet natyrore dhe ekonomike, parimet e qeverisjes intensive të pyjeve dhe tendencat e zhvillimit të pyjeve, të ekonomisë së drurit-industriale dhe ekonomisë tjetër, si dhe masat për përpërimin e pyjeve, ruajtjen dhe forcimin e funksioneve me vlerë të përgjithshme të pyjeve dhe mbrojtjen e pyjeve si pjesë e rëndësishme e ambientit të njeriut.

Baza e përgjithshme ekonomiko-pyjore përfshin veçanërisht: përshkrimin e rajonit ekonomik-pyjor, respektivisht të fondit pyjor jashtë rajonit ekonomik-pyjor, paraqitjen e gjendjes së pyjeve sipas njësive ekonomike dhe klasëve, masave për arritjen e qëllimeve të caktuara të qeverisjes, planet e qeverisjes, afatet e nxjerrjes së bazave ekonomiko-pyjore të njësive ekonomike dhe bazën ekonomiko-financiare.

Bazat e përgjithshme ekonomiko-pyjore duhet të jenë të harmonizuara me planet afatgjatë të zhvillimit ekonomik dhe me programin e zhvillimit të pylltarisë nga vendi 5 i këtij ligji.

Neni 22

Baza ekonomiko-pyjore e njësive ekonomike nxirret për një njësi ekonomike.

Baza ekonomiko-pyjore e njësive ekonomike përfshin: analizën e qeverisjes së gjertanishme të pyjeve, pasqyrën e gjendjes së pyjeve, qëllimet e qeverisjes së pyjeve, llojin dhe vëllimin e punëve, masat për arritjen e qëllimeve të qeverisjes dhe bazën ekonomiko-financiare.

Neni 23

Bazën e përgjithshme ekonomiko-pyjore dhe bazën ekonomike-pyjore të njësive ekonomike e nxjerr për periudhën dhjetëvjeçare organizata që qeveris pyjet e pronës shoqërore.

Neni 24

Bazën e përgjithshme ekonomiko-pyjore e vërteton Këshilli Ekzekutiv i Kuvendit të KSA të Kosovës.

Bazën ekonomiko-pyjore të njësive ekonomike e vërteton me vendim kuvendi i komunës me propozimin e komisionit profesional.

Në qoftë se pyjet për të cilat nxirret baza ekonomike-pyjore shtrihet në territorin e dy ose më shumë komunave, bazën ekonomike-pyjore për këto pyje e vërtetojnë me marrëveshje kuvendet e këtyre komunave.

Kuvendi i komunës e ka për detyrë që në afatin prej tre muajsh nga dita e marrjes së bazës ekonomike-pyjore të njësive ekonomike për ta vërtete-

tuar dhe marrë vendimin mbi dhënien ose mosdhënien e vërtetimit.

Në qoftë se kuvendi i komunës në afatin e caktuar nuk merr vendim mbi dhënien ose mosdhënien e vërtetimit, konsiderohet se e ka vërtetuar bazën ekonomike-pylore të njësisë ekonomike.

Neni 25

Bazën e përgjithshme ekonomike-pylore dhe bazën ekonomike-pylore të njësisë ekonomike mund ta hartojë organizata e regjistruar për këto punë dhe që e ka shërbimin e organizuar profesional.

Neni 26

Zbatimi i dispozitave të bazës së përgjithshme ekonomike-pylore dhe bazës ekonomike-pylore të njësisë ekonomike gjatë vitit bëhet në bazë të planeve vjetore të realizimit të qeverisjes së pyjeve që i nxjerr organizata e cila i qeverisë pyjet.

Plani vjetor i realizimit të qeverisjes së pyjeve përmban llojin dhe vëllimin e punëve, vendin dhe mënyrën e zhvillimit të tyre.

Neni 27

Punët e kultivimit të pyjeve duhet të kryhen për secilin vit sipas llojeve dhe vëllimit ose sipas vlerës proporcionalisht me vëllimin e prerjeve të bëra të pyjeve në vitin paraprak dhe këtë në raportin i cili ndërmjet këtyre punëve është përcaktuar me bazat nga neni 21 dhe 22 të këtij ligji.

Vëllimi i punëve nga alineja 1 e këtij neni përfshin vetëm punët të cilat kryhen nga mjetet e organizatës të cilat qeverisin pyjet.

Për çdo metër kub të drunjve të prerë organizata është e obliguar që të pyllëzojë më së paku 10 m² të sipërfaqeve.

Neni 28

Dispozitat e bazës së përgjithshme ekonomike-pylore, bazës ekonomike-pylore të njësisë ekonomike, planit vjetor të realizimit të qeverisjes së pyjeve dhe programit të qeverisjes së pyjeve janë të obligueshme.

Neni 29

Fas kalimit të afatit për të cilin është nxjerrë baza e përgjithshme ekonomike pylore, respektivisht baza ekonomike pylore e njësisë ekonomike bëhet revizioni i saj, respektivisht nxirret baza e re në vitin e parë vijues, sipas procedurës për hartimin e bazave ekonomike-pylore.

Gjatë kohës gjersa të nxirret baza e re nga alineja 1 e këtij neni, e më së shumti për një vit nga dita e pushimit të vlerës së saj, pyjet qeverisen sipas bazës që ka qenë në fuqi.

Nëse pas kalimit të afatit nga alineja 2 e këtij neni, nuk nxjerren baza të reja ekonomike-pylore të njësisë ekonomike me të njëjtën nuk mund të qeveriset më tej në bazë të planit vjetor të qeverisjes.

Në rastin nga alineja 2 e këtij neni, vëllimi i punëve të kultivimit të pyjeve nuk mund të jetë më i vogël, as vëllimi i prerjeve më i madh se mesatarja vjetore e këtyre punëve të parashikuara me bazën ekonomike-pylore afati i aplikimit të së cilës ka kaluar.

Në qoftë se gjatë zbatimit të bazës së përgjithshme, respektivisht të bazës ekonomike-pylore të njësisë ekonomike konstatohet se vëllimi i caktuar i prerjeve është më i vogël ose më i madh se që u përgjigjet mundësi të rendimentit të pyjeve ose ndryshojnë rrethanat në të cilat janë mbështetur dispozitat e tjera të bazës ekonomike-pylore, organizata mund të bëjë ndryshimet dhe plotësimet e tyre.

Ndryshimet dhe plotësimet e bazave nga alineja 5 e këtij neni bëhen sipas mënyrës dhe procedurës së caktuar për nxjerrjen e tyre, respektivisht për vërtetimin e tyre.

Neni 30

Bazat e përgjithshme ekonomike-pylore, bazat ekonomike-pylore të njësisë ekonomike dhe programet e qeverisjes së pyjeve, paraqesin tërësi në planje të synimeve themelore dhe qëllimeve të qeverisjes së pyjeve.

Neni 31

Organizata e cila qeveris pyjet në pronësinë shtetërore e ka për detyrë që në bazën e përgjithshme ekonomike-pylore, bazën ekonomike-pylore të njësisë ekonomike dhe në planin vjetor të realizimit të qeverisjes së pyjeve, t'i evidencojë punët e kryera të kultivimit dhe të prerjes së pyjeve.

Evidencimi i punëve të kryera gjatë vitit bëhet më së largu gjer më 31 mars të vitit të ardhshëm.

Neni 32

Obligimi i nxjerrjes së bazës ekonomike-pylore nga neni 21 dhe 22 të këtij ligji nuk ka të bëjë me organizatat që qeverisin pyjet në pronësinë shoqërore, sipërfaqja e të cilave nuk është më 100 hektarë.

Në rastin nga alineja 1 e këtij neni, pyjet qeverisen në bazë të planit vjetor të qeverisjes së pyjeve.

2. Kultivimi, përparimi dhe shfrytëzimi i pyjeve.

Neni 33

Me qëllim të ruajtjes së përgjithshme të vlerës së pyjeve dhe sigurimit të shtimit të përhershëm të tyre dhe të rendimentit, si dhe funksioneve me vlerë të përgjithshme të pyjeve, organizatat dhe pronarët që qeverisin pyjet e kanë për detyrë:

1. t'i pyllëzojë rrahishtat e pëpërtirra, sipërfaqet e djegur dhe sipërfaqet e zhveshura ose të rrezikuara nga faktorët natyrorë, sëmundjet e bimëve dhe shkaqeve tjera,

2. të përshtatet mënyra e qeverisjes së pyjeve të larta, të cilat paraqesin formën themelore të kultivimit të pyjeve, me kushtet e ambientit, karakteristikat biologjike të llojit të drunjve dhe gjendjen e këtyre pyjeve,

3. me masat e rritjes së pyjeve dhe masat tjera të ndihmohet përtëritja natyrore e pyjeve,

4. të aplikohen masat e selitjes (pastrimi dhe rradhimi) dhe të mbrojtjes së pyjeve, veçanërisht në pyjet ku këto masa është dashur të ishin zbatuar që më parë,

5. të mbillen koniferet në pyjet gjethërenëse, në rend të parë në pyjet e degraduara dhe në shkurret në tokat e mira.

6. të shndërrohen tipet e pyjeve të ulta në tipet e pyjeve të larta, ku ekzistenca e tyre nuk është e kushtëzuar nga vendbanimet dhe karakteristikat e llojit të drunjve.

Cilat punë dhe masa që duhet të zbatohen dhe në të cilin afat caktohet me bazën e përgjithshme, respektivisht me bazën ekonomike-pylore të njësisë ekonomike dhe me programin e qeverisjes së tyre.

Neni 34

Në kryerjen e punëve nga neni 33 të këtij ligji dhe punëve në ngritjen e pyjeve të reja dhe të mbjellura pylore, organet dhe organizatat që i qeverisin pyjet bashkëpunojnë me lëvizjen e malorëve dhe organizatat tjera.

Neni 35

Prerja e pyjeve mund të bëhet pas zgjedhjes dhe shënimit të trungjeve për prerje (shejimi).

Zgjedhja e trungjeve për prerje bëhet në pajtim me bazat ekonomike-pylore nga neni 21 dhe 22 të këtij ligji, respektivisht me programin e qeverisjes së pyjeve.

Shejimin e trungjeve për prerje në pyjet të cilat i qeverisin organizatat e bëjnë ato organizatat, kurse në pyjet që nuk i qeverisin organizatat këtë e

bënë organi komunal i administratës kompetent për punët e pylltarisë.

Neni 36

Në pyjet që përtërihen në mënyrë natyrore, prerja e pyjeve bëhet, sipas rregullit, në kohën e pushimit të vegjetacionit.

Koha e prerjes së pyjeve dhe mënyra e zgjedhjes së trunqeve përcaktohen me bazën ekonomike-pylore të njësisë ekonomike, respektivisht me programin e qeverisjes.

Neni 37

Zgjedhjen e trunqeve për prerje mund ta bëjnë personat që e kanë kryer Fakultetin e pylltarisë ose teknikun i profesionit të pylltarisë, përkatësisht personat që kanë marrë shkallën e katërt të përgatitjes profesionale të profesionit të pylltarisë profesionali teknik për qeverisjen e pyjeve.

Përfshirja nga alineja 1 e këtij neni, zgjedhjen e trunqeve për prerje në pyjet shoqërore të formës së lartë kultivuese mund ta bëjnë ekspertët pylorë me përgatitje superiore dhe me përvojë pune në këto punë.

Shejimet e trunqeve për prerje në pyjet që i qeverisin poseduesit mund t'i bëjnë edhe personat që kanë kryer shkollën për punëtorë të kualifikuar në pylltari ose shkollën e ultë pylore, ose nëse kjo përgatitje u është njohur në bazë të dispozitave të veçanta, përkatësisht të cilët kanë marrë shkallën e tretë të përgatitjes profesionale të drejtimit të pylltarisë profesionali teknik ndihmës i pylltarisë për qeverisjen e pyjeve e që janë aftësuar për kryerjen e këtyre punëve.

Personave të caktuar për kryerjen e punëve nga ky nen, organet dhe organizatat të cilat qeverisin pyjet u lëshojnë vendime me të cilat autorizohen për kryerjen e shejimit të trunqeve.

Neni 38

Druri nga pylli nuk guxon të hiqet nga vendi i prerjes gjersa të dëmkoset me dëmkë të pyjeve.

Ndalohet qarkullimi i drunjve që nuk janë të dëmkosur dhe për të cilët është dhënë fletëpërcjellësja.

Dispozitat e alineve 1 dhe 2 të këtij neni kanë të bëjnë edhe me drunjë të prerë jashtë pyllit (drunjë të prerë dhe trupat e drunjve të ale, livadhe, kullosa, ara etj.), në qoftë se këta lëshohen në qarkullim, ose përpunohen në stabilimentet për përpunimin primar të drurit.

Qarkullimi i drurit, në vështirim të këtij ligji, kuptohet blerja, shitja dhe dhurimi i drurit, si dhe transporti i drurit nëpër rrugët e komunikacionit me të gjitha mjetet motorike.

Dëmkosjen e drurit dhe dhënien e fletëpërcjellësve për drunjë nga pyjet në pronësinë shoqërore e bëjnë organizatat që i qeverisin këto pyje, kurse për drunjë nga pyjet në të cilat ekziston e drejta e pronësisë, këtë e bënë organi komunal i administratës kompetente për punët e pylltarisë.

Sortimente të drurit në të cilat nuk mund të vëhet dëmkë (nga pastrimi, rrallimi, thëngjilli i drurit, cungat etj.), nuk mund të hiqen nga vendi i prerjes pa fletëpërcjellës.

Ndalohet blerja e sortimenteve të drunjve të padëmkosur dhe pa fletëpërcjellës.

Neni 39

Ndalohet shkatërrimi dhe shpyllëzimi, prerja e tërësishme e cila nuk është lejuar si formë e rregullit të përtëritjes së pyjeve, shitja e drunjve të prerë, prerja e llojeve të rralla të drunjve, zbardhimi i trunqeve, kullotja dhe brerja e dhive dhe e shtazëve tjera, grumbullimi i lëndëve, kultivimi i pyjeve me lëndë, prerja e lëndëve, grumbullimi i shkarpeve dhe i myshqeve, prerja e elementeve të farës dhe të trunqeve të farës që nuk janë parashikuar me bazën e përgjithshme ekonomike-pylore dhe bazën ekonomike-pylore të njësisë ekonomike,

uzurpimi arbitrar i pyjeve, asgjësimi apo dëmtimi i shenjave dhe shenjave kufitare, hudhja e plehut dhe e mbeturinave, si dhe ndotja e pyjeve në mënyrë tjetër dhe veprime të tjera me të cilat dobësohet aftësia e rendimentit të pyllit apo rrezikohet funksioni i pyllit, nëse me ligj nuk është rregulluar ndryshe.

Shkretërimi i pyjeve konsiderohet çdo veprim i kryer në kundërshtim me dispozitat me të cilin dobësohet frytshmëria (fuqia e rendimentit) e tokës pylore dhe me këtë rrezikohet ose pamundësohet që ndrueshmëria e prodhimit pylorë apo kultivimi i pyjeve në këtë tokë apo rrezikohet ekzistenca e pyjeve dhe i funksionve të tyre me vlerë të përgjithshme (prerja në vëllim më të madh e cila i afrohet qeljes së tërësishme të pyjeve, prerja me intenzitet të madh, zbardhimi i trunqeve, çdo veprim i cili mund të shkaktojë paraqitjen e barojave, shpërlarjen dhe bajljen e dheut me anë të ujit ose me anë të erës etj.).

Neni 40

Qelizma e pyjeve mund të bëhet me qëllim të ndryshimit të llojit të drunjve apo ndryshimit të formave të kultivimit të pyjeve, ndërtimit të objekteve ekonomike dhe objekteve të standardit shoqëror, rrugëve publike dhe pylore, zgjerimit dhe ndërtimit të qyteteve dhe vendbanimeve, hapjes së qelizmave pylore, themelimit të fidanishteve pylore dhe shndërrimit të tokës pylore në tokë bujqësore e cila vazhdimisht do të ketë dobi më të madhe se pylli, nëse me qelizma nuk rrezikohen funksionet mbrojtëse të pyjeve.

Neni 41

Frerja e tërësishme e pyjeve e cila nuk është parashikuar si formë e rregullit të përtëritjes së pyjeve mund të bëhet me qëllim të ndërtimit të largpërcuese, teleferikeve dhe objekteve të ngjashme, rrugëve të përkohshme pylore dhe objekteve tjera të përkohshme që shërbejnë për qeverisjen e pyjeve, hapja e vijave kundër zjarrit për shuarjen e zjarrit të madh të pyjeve, hapjen e kalimeve për kryerjen e punëve gjeodetike dhe punëve të ngjashme, luftimin e sëmundjeve të bimëve dhe insekteve të dëmshme, si dhe kur për shkak të dukurive tjera natyrore është rrezikuar shumica e drunjve pylorë, nëse me këtë nuk rrezikohen funksionet e pyjeve.

Neni 42

Qelizma, respektivisht prerja e tërësishme e pyllit për qëllimet nga nenet 40 dhe 41 të këtij ligji, mund të bëhet në pyjet që i qeverisin organizatat në bazë të vendimit të organeve vetëqeverisëse të asaj organizate, kurse në pyjet ku ekziston e drejta e pronësisë në bazë të lejes së organit komunal të administratës kompetent për punët e pylltarisë.

Me vendim, respektivisht lejen për qelizimin e pyjeve me qëllim të ndërtimit të llojit të drunjve ose ndryshimit të formave të kultivimit të pyjeve dhe shndërrimit të tokës së pyjeve në tokë bujqësore caktohet mënyra dhe afati në të cilin do të bëhet pyllzimi respektivisht shndërrimi i tokës pylore në tokë bujqësore.

Neni 43

Për pyllin në pronësinë shoqërore të qelizma me qëllim të ndërtimit të objekteve ekonomike dhe objekteve të standardit shoqëror dhe rrugëve publike, për zgjerimin dhe ndërtimin e qyteteve dhe vendbanimeve, si dhe për shndërrimin e tokës pylore në tokë bujqësore, organizatës duhet t'i kompensohet vlera e punës së bërë dhe e mjeteve në atë pyll. Mjetet e kompensimit nga alineja 1 e këtij neni qiten në fondin afarist dhe mund të shfrytëzohen vetëm për ngritjen e pyjeve të reja.

Neni 44

Prerja e trunqeve të pamjes malore dhe kodrinore, tisë, lejthisë së egër, trunqeve të ndarë dhe

të pranuar të farës dhe të përbërjeve si dhe të disa trunjeve të rralluara apo të rrezikuar të drunjve pyjorë të cilrat janë të siguruara me dispozita të veçanta, nuk është e lejueshme.

Trunjtet e drunjve pyjorë nga alineja 1 e këtij neni, nëse janë të thatë ose shumë të dëmtuar dhe kështu paraqesin qerdhe të infektiveve nga sëmurjet bimore dhe dëmtuesit, si dhe në raste tjera të përcaktuara me dispozita, mund të prehen me leje të organit komunal të administratës kompetent për punët e pylltarisë.

Neni 45

Zgjedhja e trasesë me qëllim të ndërtimit të largpërçuesve dhe objekteve të ngjashme në pyll dhe mënyra e prerjes së drunjve në trase përcaktohen me marrëveshje ndërmjet organizatës, respektivisht pronarit të pyllit dhe investitorit ose kryesit të punëve.

Në qoftë se arrihet marrëveshja, mënyrën e prerjes së pyllit dhe zgjedhjen e trasesë e përcakton organi komunal i administratës kompetent për punët e pylltarisë, me pëlqimin e organit komunal të administratës kompetent për punët e urbanizmit.

Neni 46

Kullotja, përveç kullotjes dhe mbrojtjes së dhive, përjashtimisht mund të bëhet në pyjet në të cilat rritja e drunjve është e atillë që kafshët me bregtjen e mungullit dhe pipave nuk mund t'u shkaktojnë dëm, në të cilat nuk bëhen punët e meliorimit, në të cilat nuk është në zhvillim e sipër përtëritja artificiale apo natyrale, të cilat gjenden në tokën që i ekspozohet erës, rrëshqitjes, shpërlarjes dhe shembjes, që nuk janë të dëmtuara nga zjarri, që nuk janë të ndara si përbërje e farës dhe në të cilat nuk bëhet mbledhja e rrëshirës.

Në pyjet që mund të shfrytëzohen për kullosa të cilat i qeverisin organizatat, pronarët e kafshëve mund të bëjnë kullotjen e kafshëve vetëm nën mbikëqyrjen e barinjve të kafshëve dhe me lejen e organizatës e cila qeveris me pyjet.

Kushtet tjera nën të cilat mund të bëhet kullotja (koha e kullotjes, lloji i kafshëve, numri i kre-rëve, lartësia e shpërblimit etj.), i përcakton organizata që qeveris me pyjet, e për pyjet ku ekziston e drejta e pronësisë, pronarët e pyjeve.

Organizata e cila qeveris pyjet e ka për detyrë që me shenjat e dukshme mbi ndalimin e kullosës të shënojë pyjet në të cilat as përjashtimisht nuk mund të bëhet kullotja.

Neni 47

Hyrja e kafshëve në kullosa dhe vendet për pirjen e ujit, në pyjet në të cilat nuk është lejuar kullosa, mund të bëhet vetëm nëpër rrugët që i cakton organizata që i qeveris pyjet.

Organizata që i qeveris pyjet e ka për detyrë të caktojë dhe t'i shënojë rrugët për grahjen e kafshëve nëpër pyje në të cilat nuk lejohet kullosa.

Neni 48

Mbledhja e bimëve mjekuese dhe bimëve tjera, e fryteve pyjore, farës dhe prodhimeve tjera pyjore, mund të bëhet vetëm në atë masë me të cilën nuk do të rrezikohet vazhdueshmëria e prodhimit dhe as nuk i sjellet dëm pyllit.

Guri, zhavorri, rëra dhe përbërjet tjera të tokës pyjore mund të shfrytëzohen vetëm në vendet ku me shfrytëzimin e tyre nuk do të shkaktohet rrëshqitja, shpërlarja apo shembja e tokës ose t'i shkaktohet dëm pyllit.

Shfrytëzimi i prodhimeve nga alinetë 1 dhe 2 të këtij neni mund të bëhet me lejen e organizatës që qeveris pyjet, në mënyrë dhe nën kushte që ajo i cakton.

Neni 49

Organizata që qeveris pyjet e rajonit të ekonomisë pyjore, disa pyje me shpërblim mund t'u caktojë organizatave tjera me pëlqimin e Kuvendit të KSAK të Kosovës.

Organizata e cila të drejtën e shfrytëzimit të pyllit e bartë në organizatën tjetër ka të drejtë kompensimin e vlerës së paamortizuar të mjeteve të investuara nga organizata së cilës i bartet kjo drejtë, në qoftë se pylli bartet me qëllim të shfrytëzimit për qëllime tjera, e jo për atë nga neni i këtij ligji, ka të drejtë që më parë të shfrytëzojë edhe masën e drurit të këtij pylli.

Në qoftë se organizata që qeveris pyjet nga alineja 1 e këtij neni nuk mund të shfrytëzojë masën e drurit ka të drejtë në kompensimin e vlerës së pyllit.

Në rast kontesti, vlerën e pyllit nga alineja 2 të këtij neni e cakton gjykata kompetente ekonomike.

Mjetet nga alinetë 1 dhe 2 të këtij neni mund të shfrytëzohen vetëm për blerjen e pyjeve tjera ose për ngritjen e pyjeve të reja në afatin e përcaktuar me bazën ekonomike-pyjore të njësisë ekonomike.

Neni 50

Organizatave që i qeverisin pyjet, respektivisht pronarët e pyjeve janë të detyruar ta bëjnë pyllëzimin e sipërfaqeve në të cilat nuk ka pasur suksese përtëritja dhe pyllëzimi, si dhe sipërfaqet në të cilat është bërë shkretërimi i pyjeve, prerja e tërës shune, e pa leje ose qilizima e pyjeve.

Organizatave dhe personat nga alineja 1 e këtij neni e kanë për detyrë që pyllëzimin ta bëjnë në afatin që e cakton organi komunal i administratës kompetent për punët e pylltarisë, nëse ky afat nuk është caktuar me bazën ekonomike-pyjore të njësisë ekonomike, respektivisht me programin e qeverisjes.

Neni 51

Në pyll mund të kultivohen vetëm ato lloje të egër sirave dhe në atë mënyrë që nuk pengon qeverisjen e drejtë të pyjeve.

Lloji dhe numri i egër sirave që mund të kultivohen në pyll caktohen me bazën ekonomike-pyjore të njësisë ekonomike në pajtim me dispozitatë mbi gjuetinë.

Baza ekonomike-pyjore e njësisë ekonomike dhe baza ekonomike e gjuetisë duhet të jenë të harmonizuara reciprokisht.

Gjersa të nxirret baza ekonomike-pyjore e njësisë ekonomike organi kompetent për vërtetimin e bazës ekonomike të gjuetisë e ka për detyrë, për ngrerjen së aktvendimit mbi vërtetimin e saj, nga organizata pyjet e së cilës janë përfshirë në terret të gjuetisë për të cilat vërtetohet baza ekonomike e gjuetisë, të marrë mendimin mbi atë se llojet e zgjedhura dhe numri i egër sirave të përcaktuara me bazën ekonomike të gjuetisë e pengojnë qeverisjen e drejtë të pyjeve.

Neni 52

Rrugët që shërbejnë në rend të parë për transportin e prodhimeve pyjore e që shënohen si mjete themelore të organizatave që i qeverisin pyjet, konsiderohen rrugë pyjore.

Rrugët pyjore mund t'i shfrytëzojnë edhe organizatat tjera, personat civilo-juridikë dhe qytetarët nën kushtet e përcaktuara në aktin e përgjithshëm të organizatës të cilës i takojnë këto mjete themelore.

Për shfrytëzimin e rrugëve pyjore për qëllime ekonomike, organizata së cilës i takojnë këto mjete themelore mund të caktojë pagimin e kompensimit dhe lartësinë e tij.

Neni 53

Pronari, respektivisht shfrytëzuesi i tokës e ka për detyrë të lejojë transportin e përkohshëm dhe vendosjen e prodhimeve pyjore në tokën e vet (në tekstin e mëtejshëm: servituti), në qoftë se kjo nuk ka mundësi të bëhet në mënyrë tjetër ose në qoftë se mënyra tjetër do të ishte shumë më e shtrenjtë. Shfrytëzuesi i servitutit e ka për detyrë që pronarit, respektivisht shfrytëzuesit të tokës t'ia paguaj kompensimin.

Aktvendimin mbi vënien e servitutit nga alineja 1 dhe të lartësisë së kompensimit nga alineja 2 të këtij neni me kërkesën e personit të interesuar, e merr organi komunal i administratës kompetent për punët e pylltarisë.

Ankesa kundër aktvendimit mbi vënien e servitutit nuk e ndalon ekzekutimin e aktvendimit.

Kundër aktvendimit mbi lartësinë e shpërblimit nga alineja 3 e këtij neni nuk lejohet ankesa, dhe nuk mund të hapet kontesti administrativ, por të dy palët, në afatin prej një muaji nga dita e dorëzimit të aktvendimit, mund të paraqesin propozimin që gjykata të përcaktojë lartësinë e shpërblimit.

Për propozimin e caktimit të shpërblimit vendos në procedurën jashtëkontestimore gjykata komunale në territorin e së cilës gjendet toka në të cilën vëhet servituti.

3. Mbrojtja e pyjeve

Neni 54

Organizatata që i qeverisin pyjet dhe pronarët e pyjeve e kanë për detyrë të ndërmarrin masat me qëllim të mbrojtjes së pyjeve nga zjarri dhe fatkeqësitë tjera elementare, sëmundjet e bimëve, dëmtuesit dhe dëmet tjera.

Neni 55

Organizatata, respektivisht pronarët e pyjeve që i qeverisin pyjet e kanë për detyrë që të gjitha punët e qeverisjes së pyjeve t'i organizojnë dhe t'i kryejnë me kohë dhe mënyrë me të cilën sigurohet ruajtja e rendit pyjor.

Rendi pyjor nënkuptohet gjendja e atillë në pyje e cila siguron kushtet për ruajtjen e tij, përtëritjen dhe përshtatjen, e veçanërisht: mbrojtjen nga zjarri, sëmundjet e bimëve dhe dëmtuesit, mbrojtjen e tokës pyjore nga paraqitja dhe zhvillimi i proceseve të erozionit për shkak të prerjes apo bartjes së drunjve nga pylli, mbrojtjen e trungjeve të reja, pengimin e dëmtimit të trungjeve me rastin e prerjes apo të bajtjes etj.

Në qoftë se në qeverisjen e pyjeve apo nga shkaqet e tjera prishet rendi pyjor, organizatat, respektivisht pronarët e pyjeve që i qeverisin pyjet e kanë për detyrë që në kohën e caktuar dhe në mënyrën e caktuar të vendosin rendin pyjor.

Organizatata që qeveris pyjet përcakton masat me qëllim të ruajtjes dhe vendosjes së rendit pyjor, si dhe mënyrën dhe kohën e zbatimit të këtyre masave.

Neni 56

Ndalohet ndezja e zjarrit të hapur në pyje.

Përfshirësisht nga dispozita e alinesë 1 të këtij neni, personat që nga shkaqet e arsyeshme qëndrojnë në pyll (punëtorët pyjorë, turistët etj.), mund të ndezin zjarrin e hapur në pyll vetëm në vendet e caktuara dhe të siguruar për këtë, duke iu përmbajtur kushteve dhe masave të sigurisë që i përcakton organizata për pyjet që i qeveris, respektivisht Këshilli Ekzekutiv i Kuvendit të Komunës për pyjet në të cilat ekziston e drejta e pronësisë.

Zjarr i hapur konform dispozitave të alinesë 1 të këtij neni nuk konsiderohet ndezja e zjarrit në

ndërtesa dhe në objekte tjera në të cilat është rregulluar dhe siguruar gropa e zjarrit që pengon përhapjen e zjarrit.

Neni 57

Ruajtjen, respektivisht mbrojtjen e pyjeve nga shfrytëzimi i paligjshëm, përvetësimi, zjarri dhe veprimet tjera të paligjshme (mëturje: ruajtja e pyjeve) e bën organizata që i qeveris pyjet.

Me qëllim të ruajtjes së pyjeve organizata organizon shërbimin e ruajtjes së pyjeve dhe i cakton të drejtat dhe detyrat e rojtarëve të pyjeve.

Neni 58

Rojtari i pyjeve ka të drejta dhe detyra që janë të përcaktuara me dispozitat mbi bazat e vetëmbrojtjes shoqërore për personat që ushtrojnë drejtpërdrejt punët e sigurimit të pasurisë shoqërore.

Rojtar i pyjeve mund të jetë personi që ka kryer shkollën për punëtor të kualifikuar të pylltarisë, përkatësisht i cili e ka marrë shkollën e tretë të përgatitjes profesionale të pylltarisë, profesioni teknik ndihmës i pylltarisë për qeverisjen e pyjeve ose shkollën e ulët të pylltarisë se kjo përgatitje i është pranuar në bazë të dispozitave të veçanta, e i plotëson kushtet për bartjen e armëve dhe kushtet tjera të përcaktuara nga ana e organizatës që i qeveris pyjet.

Neni 59

Në kryerjen e shërbimit të ruajtjes së pyjeve rojtari i pyjeve është i autorizuar:

1. të legjitimojë personat e gjetur në kryerjen e kundërvajtjeve që ndëshkohen sipas këtij ligji apo të veprës penale që ka të bëjë me pyjet, ose për të cilin ekziston dyshimi i bazuar se kanë kryer vepra të këtylla, në qoftë se nuk mund ta konstatojë identitetin e atij personi në ndonjë mënyrë tjetër,
2. të bëjë kontrollin e të gjitha llojeve të qerreve me të cilat transportohet druri dhe të gjitha llojeve të ngarkesave në të cilat transportohen drunjtë me qëllim të gjetjes së sendeve, të veprës penale apo të kundërvajtjes.

3. të bëjë kontrollin e vendit ku gjenden drunjtë, përveç banesave dhe lokaleve tjera me qëllim të gjetjes së sendeve të veprës penale apo të kundërvajtjes,

4. përkohësisht t'i marrë sendet me të cilat është bërë vepra penale apo kundërvajtja dhe sendet që janë krijuar apo siguruar me kryerjen e veprës së atillë dhe këto sende pa shtyerje t'ia dorëzojë organit kompetent,

5. të kujdeset mbi uzurpimin arbitrar të pyjeve që i qeveris organizata, si dhe mbi luejtjen e kufirit të pyjeve dhe mbi këtë menjëherë ta lajmërojë organizatën.

Neni 60

Rojtari i pyjeve kryen detyrën e ruajtjes së pyjeve në rrobat zyrtare (uniformë) dhe është i armatosur me armët që i cakton organizata.

Rojtari i pyjeve ka legjitimacionin e rojtarit të pyjeve.

Legjitimacionin e rojtarit të pyjeve e jep organizata në të cilën rojtari i pyjeve është në marrëdhënie pune.

Neni 61

Ndalohet lëvizja e personave nëpër pyje, jashtë rrugëve publike me sopatë, sharrë apo vegla të ngjashme pa lejen e organizatës që i qeveris pyjet.

Neni 62

Kompensimi i dëmit që është bërë në pyjet e pronësisë shoqërore llogaritet në bazë të çmimeve

të caktuara në listen e çmimeve për kompensimin e dëmeve pyjore.

Listën e çmimeve nga alinea 1 e këtij neni e nxjerr Këshilli Ekzekutiv i Kuvendit të KSA të Kosovës.

Neni 63

Qytetarët mund të bëjnë përpunimin primar të drurit si veprimtari zëjtare-shërbyese, në qoftë se stabilimentet në të cilat bëhet përpunimi primar i drurit i plotësojnë kushtet e përcaktuara teknike dhe kushtet tjera.

Stabilimentet nga alinea 1 e këtij neni mund të vendosen vetëm në vendet e banuara që i cakton kuvendi i komunës, apo pranë vijave të komunikacionit në përdorimin publik, respektivisht të përgjithshëm në largësi të vendbanimeve të caktuara të cilën e cakton organi i administratës që e cakton kuvendi i komunës.

Stabilimentet për sharritjen shërbyese të drurit nuk mund të vendosen në pyje apo rrënzë malit.

Pronari i stabilimenteve nga alinea 1 e këtij neni e ka për detyrë të mbajë librin e sharritjeve shërbyese.

Kushtet nga alinea 1 e këtij neni, si dhe përmbajtjen dhe mënyrën e mbajtjes së librit të sharritjes shërbyese e përcakton udhëheqësi i organit krahinor të administratës kompetent për punët e ekonomisë në marrëveshje me udhëheqësin e organit krahinor të administratës kompetent për punët e pylltarisë.

Organi komunal i administratës kompetent për punët e pylltarisë, në marrëveshje me organin komunal të administratës kompetent për punët zëjtare do t'iu ndalojë qytetarëve kryerjen e përpunimit primar të drurit në stabilimentet të cilat nuk i plotësojnë kushtet e përcaktuara ose nëse pronari i stabilimenteve nuk e mbanë librin e sharritjes shërbyese.

Neni 64

Në sharra dhe stabilimentet tjera ndalohet kryerja e përpunimit primar të drurit që nuk është dëmkosur me dëmkën pyjore dhe nëse për këtë dru nuk është dhënë fletëpërcjellësja.

Përfashtimisht nga alinea 1 e këtij neni drunjtë që janë blerë në depon e organizatës të regjistruar për qarkullimin e drunjve me shumicë dhe pakicë mund të pranohen për sharritje në bazë të faturës së kësaj organizate, e cila përmban të dhënet mbi llojin dhe sasinë e drurit.

Neni 65

Ndalohet prodhimi i pragjeve të gëdhendur të hekurudhës.

Përfashtimisht kuvendi i komunës mund të lejojë prodhimin e pragjeve të gëdhendur të hekurudhës në pyjet apo në pjesët e tyre nga të cilat nuk është e mundur të transportohet druri gjer të stabilimentit për sharritjen e pragjeve të hekurudhës apo kur prodhimin i pragjeve të sharritur nga pyjet e këtilla, respektivisht nga pjesët e tyre është ekonomikisht i paarsyeshëm.

Me vendimin nga alinea 2 e këtij neni caktohet afati gjer kur mund të bëhet prodhimi i pragjeve të gëdhendur të hekurudhës.

Neni 66

Kuvendi i komunës apo organi që e cakton ky përfashtimisht mund të lejojë prerjen e dushkut në pyjet që i qeverisin pronarët në vitin në të cilin është paraqitur mungesa e ushqimit të kafshëve për shkak të thatësisë apo fatkeqësive elementare dhe të përcaktojë kushtet e prerjes së dushkut.

V. PYJET MBROJTESE DHE PYJET ME DESTINIM TË VEÇANTË

Neni 67

Kuvendi i komunës shpall pyllin për pyll mbrojtës apo pull me destinim të veçantë, nëse me të nuk është rrogulluar ndryshe.

Para shpalljes së pyllit nga alinea 1 e këtij neni, kuvendi i komunës siguron mendimin nga organizata që qeveris këtë pyll respektivisht pronari pyllit.

Shpalljen e pyjeve mbrojtëse, respektivisht pyjeve me destinim të veçantë, që shtrihen në territorin e dy ose më shumë komunave e bëjnë me marrëveshje kuvendet e këtyre komunave.

Përfashtimisht nga dispozita e alineave 1 dhe 2 të këtij neni shpalljen e pyjeve në pronësinë shoqërore për pyje mbrojtëse dhe pyje me destinim të veçantë, nëse këto pyje respektivisht pjesët e tyre janë më të mëdha se 20 ha dhe gjenden në territorin ekonomikopyjor, e bën Këshilli Ekzekutiv i Kuvendit të KSA të Kosovës pas mendimit të siguruar nga organizata që i qeveris këto pyje.

Neni 68

Me aktin me të cilin shpallet pyll mbrojtës apo pyll me destinim të veçantë caktohen masat që duhet të ndërmerren për qeverisjen e këtyre pyjeve me qëllim të realizimit të destinimit për të cilin pylli është shpallur e mbrojtës, respektivisht pyll me destinim të veçantë.

Mjetet për zbatimin e masave nga alinea 1 të këtij neni i siguron organizata apo personi tjetër juridik me kërkesën e të cilit pylli është shpallur mbrojtës, respektivisht me destinim të veçantë.

Pyllin e shpallur për mbrojtës apo pyllin me destinim të veçantë e qeveris organizata respektivisht pronari i cili e ka qeveris gjer në shpallje.

Në qoftë se pylli i shpallur mbrojtës apo pyll me destinim të veçantë gjendet në kuadër të rajonit ekonomikopyjor, Kuvendi i KSA të Kosovës këtë pyll do ta ndajë nga rajoni, nëse këtë e kërkon organizata që qeveris këtë pyll.

Neni 69

Organizata, personi tjetër juridik dhe qytetari pylli i të cilit është shpallur mbrojtës, respektivisht pyll me destinim të veçantë ka të drejtë kompensimi, nëse me këtë shpallje kufizohet e drejta e shfrytëzimit, respektivisht e drejta e pronësisë në këtë pyll, gjatë kohës së zgjatjes së kufizimit.

Kompensimin nga alinea 1 e këtij neni e cakton gjykata.

VI. CAKTIMI I KUFIJVE TË PYJEVE

Neni 70

Kufijtë e pyjeve në pronësinë shoqërore që nuk janë caktuar, caktohen me aktvendimin e organit të cilin e cakton kuvendi i komunës me kërkesën e organizatës që qeveris pyjet.

Procesverbali i caktimit të kufijve dhe skicat e përkufizimit janë pjesë përbërëse e aktvendimit nga alinea 1 e këtij neni. Vija kufitare përkufizohet sipas dispozitave për caktimin e kufijve në procedurën e matjes së tokës.

Aktvendimi mbi caktimin e kufijve të pyjeve i nënshtrohet kontrollit publik gjatë kohës e cila nuk mund të jetë më e shkurtër se 60 ditë.

Neni 71

Personat që mendojnë se me aktvendimin mbi caktimin e kufijve të pyjeve u është shkelur e drejta, në afatin prej 30 ditësh nga dita e skadimit të afatit nga neni 70 alinea 3 të këtij neni, gjykatës së

kompetencës së përgjithshme mund t'i paraqesin padinë me qëllim të konstatimit të të drejtave të veta.

Paraqitja e padisë nga alinea 1 e këtij neni nuk e shtyen ekzekutimin për më vonë të aktvendimit mbi caktimin e kufijve të pyjeve.

VII. KADASTRI I PYJEVE

Neni 72

Kadastri i pyjeve aplikohet me qëllim të mbajtjes së evidencës mbi gjendjen dhe ndryshimet në pyje.

Kadastri i pyjeve përfshin të dhënat mbi sipërfaqen masën e drurit, rritjen, rendimenin dhe pajisjen teknike të pyjeve, si dhe mbi ndryshimet që janë bërë në to.

Mënyrën e caktimit dhe mbajtjes së kadasit të pyjeve e përcakton Këshilli Ekzekutiv i Kuvendit të KSA të Kosovës.

Neni 73

Kadastri i pyjeve e vë dhe e udhëheq organi komunal i administratës kompetent për punët e pylltarisë për të gjitha pyjet në territorin e komunës.

Organizatata dhe personat tjerë juridikë që i qeverisin pyjet e kanë për detyrë t'ia dërgojnë organit nga alinea 1 e këtij neni të dhënat e nevojshme me qëllim të vënies së kadastrit të pyjeve dhe më së largu gjer më 31 mars të vitit të ardhshëm ta njohin mbi të gjitha ndryshimet e bëra gjatë vitit të kaluar të cilat ndikojnë në udhëheqjen e kadastrit të pyjeve.

VIII. SIGURIMI I MJETEVE PËR RIPRODHIMIN BIOLOGJIK TË PYJEVE

Neni 74

Për financimin e punëve nga neni 20 të këtij ligji formohen mjetet që sigurojnë riprodhimin e fondit pyjor, në mënyrën e përcaktuar me këtë ligj.

Vëllimi i mjeteve nga alinea 1 e këtij neni përcaktohet me bazën ekonomike-pylore.

Neni 75

Mjetet për riprodhimin e pyjeve formohen nga këto burime:

1. Amortizimi

Me aplikimin e shkallëve në bazën për llogaritjen e amortizimit të pyjeve të cilën e përbënë vlera e realizuar e sortimenteve pyjore në vitin për të cilin bëhet ndarja e këtyre mjeteve:

— sipas shkallës 10% nga vlera shitëse e drunjve në pyll pranë trungut ose në depon ndihmëse pyjore.

— sipas shkallës prej 8% nga vlera e shitjes së drunjve në rugën pyjore të kamionëve;

2. Burimet tjera

— sipas shkallës 4% nga vlera e realizuar e produkteve pyjore të dorës së dytë,

— mjetet e realizuara në emër të kullosave pyjore në lartësi prej 50%,

— mjetet e realizuara nga gjobet e paguara për deliktet ekonomike dhe veprat penale në lëmi e pylltarisë,

— mjetet nga realizimi i kompensimit të dëmeve sipas listës së çmimeve për kompensimin e dëmeve pyjore në lartësi prej 50%,

— për produktet e dedikuara përpunimit mekanik dhe kimik të drurit, OPB të përpunimit mekanik dhe kimik të drurit në lartësi prej 5% të çmimit blerës të drurit,

— për produktet e drurit të dedikuara qarkullimit OPB të qarkullimit të produkteve pyjore në lartësi prej 5% të çmimit blerës të këtyre produkteve,

— për produkte pyjore të dorës së dytë (gurë, rërë, zhvavorri dhe fryte pyjore, bimë shëruese, kërpudha), OPB të të cilat mirren me grumbullimin, blerjen, qarkullimin dhe përpunimin e këtyre produkteve në lartësi prej 4% të çmimit shitës të këtyre produkteve.

Neni 76

Llogaritja e mjeteve për riprodhimin e pyjeve bëhet brenda afateve që i cakton organizata e më së largu brenda afatit të paraparë për paraqitjen e llogarisë periodike.

Llogaritja definitive e mjeteve për riprodhimin e pyjeve bëhet me llogarinë përfundimtare.

Neni 77

Mjetet për riprodhimin e pyjeve nga neni 75 alinea 1 e këtij ligji të llogaritura gjatë vitit shfrytëzohen:

— së paku 50% të shumës së llogaritur për punët për mirëmbajtjen e pyjeve ekzistuese dhe për ngritjen e pyjeve të reja,

— pjesa e mbetur e mjeteve për punët dhe destinimet tjera të parapara në bazën ekonomik-pylore të njësisë ekonomike.

Neni 78

Nga mjetet e realizuara për riprodhimin e pyjeve nga neni 77 të këtij ligji organizata gjatë vitit ndan dhe i paguan,

— 50% të mjeteve për financimin të riprodhimit të thjeshtë të pyjeve,

— 50% të mjeteve për financimin e punëve të riprodhimit të zgjeruar të pyjeve.

Organizata e cila i realizon mjetet nga alinea 1 e këtij neni i mban në fondin afarist dhe është e obliguar që t'i evidencojë posaçërisht.

Neni 79

Mjetet për realizimin e punëve dhe të detyrave të riprodhimit të pyjeve në të cilat ekziston e drejta e pronësisë i sigurojnë pronarët e pyjeve në lartësi prej 10% të vlerës shitëse të drunjve.

Neni 80

Organizatata themelore të punës së bashkuar dhe organizatat punuese të pylltarisë dhe personat tjerë shoqëror-juridikë të cilët qeverisin me pyjet në pronësinë shoqërore dhe pronarët e pyjeve mjetet nga neni 75 alinea 1 pika 2 neni 78 alinea 1 pika 2 dhe neni 79 të këtij ligji i bashkojnë me qëllim të sigurimit të mjeteve për riprodhimin e zgjeruar të pyjeve.

Bashkimi i mjeteve nga alinea 1 e këtij neni bëhet me marrëveshje vetëqeverisëse.

Me marrëveshjen vetëqeverisëse mbi bashkimin e mjeteve përcaktohet periudha e bashkimit e cila nuk mund të jetë më e shkurtër nga periudha afatmesme e planit, kushtet e bashkimit, qëllimin e qëllimin e mjeteve të kush bashkohen dhe çështjet tjera me rëndësi për rregullimin vetëqeverisës të marrëdhënieve të bashkimit.

Neni 81

Nëse marrëveshja vetëqeverisëse nga neni 80 alinea 2 të këtij ligji nuk lidhet në afat prej 6 muajsh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji, mjetet për realizimin e programit të riprodhimit të zgjeruar të pyjeve ndahen dhe i bashkojnë:

— organizatat themelore të punës së bashkuar të pylltarisë, përkatësisht organizatat punuese në

lartësi prej 50% të shumës së llogaritur sipas nenit 75 alineja 1 pika 1 dhe lartësisë së mjeteve të llogaritura nga neni 75 alineja 1 pika 2 të këtij ligji,

— organizatat themelore të punës së bashkuar të përpunimit mekanik dhe kimik të drurit në lartësi prej 5% të çmimit blerës të drurit,

— organizatat e punës së bashkuar të cilat mirren me grumbullimin, blerjen, qarkullimin dhe përpunimin e produkteve pyjore të dorës së dytë në lartësi prej 4% të çmimit shitës të këtyre produkteve.

Mjetet e llogariture sipas alinesë 1 të këtij neni ndahen sipas llogarisë periodeke dhe llogarisë përfundimtare paguhen në llogari të posaçme sipas rajoneve ekonomike pyjore.

Neni 82

Organizata e cila qeveris me pyjet në rajonet ekonomike pyjore të pyjeve të ulta dhe të degraduara rendimenti i gjithmbarshëm vjetor i masës së drurit të së cilës, llogaritur sipas bazave ekonomike pyjore nuk siguron mjete në të holla që janë të nevojshme për mbulimin e shpenzimeve të qeverisjes dhe ruajtjes së fondit pyjor, e këto mjete nuk mund të realizohen prej kurrfarë burimesh të tjera të mjeteve të organizatës, mjetet plotësuese do t'i sigurojë bashkësia shoqërore politike e cila e ka themeluar rajonin ekonomik pyjor.

Kushtet dhe kriteret më të hollësishme për sigurimin dhe ndarjen e mjeteve plotësuese organizatës sipas alinesë 1 të këtij neni i nxjerrë Këshilli Ekzekutiv i Kuvendit të KSA të Kosovës.

IX. FONDI PËR RIPRODHIMIN E ZGJERUAR TË PYJEVE TË KOSOVËS

Neni 83

Me qëllim të sigurimit të mjeteve për financimin e punimeve të riprodhimit të zgjeruar të pyjeve nga neni 20 të këtij ligji, formohet Fondi për riprodhimin e zgjeruar të pyjeve të Kosovës.

Selia e Fondit është në Prishtinë.

Neni 84

Fondi ka cilësinë e personit juridik.

Neni 85

Mjetet për realizimin e punëve dhe të detyrave të Fondit sigurohen nga:

1. mjetet të cilat për përparimin e pylltarisë i siguron KSA e Kosovës me ligj apo dispozitë tjetër,

2. mjetet të cilat për këto destinime i bashkojnë OPB sipas marrëveshjes së posaçme,

3. mjetet të cilat i realizon Fondi nga kreditë e marra, afatizimi i mjeteve të OPB, kamatat nga mjetet e Fondit të bashkuara në Bankë dhe burimet tjera.

Neni 86

Mjetet e Fondit orientohen dhe shfrytëzohen në bazë të programeve dhe projekteve në pajtim me planet afatgjatë të zhvillimit të pylltarisë.

Neni 87

Fondi:

— ndjek politikën e riprodhimit të zgjeruar të pyjeve në Krahinë të përcaktuar me planin shoqëror me marrëveshjet dhe me dokumentet tjera të planit,

— përcakton mënyrën e shfrytëzimit të mjeteve të Fondit për realizimin e punëve të cilat kanë të bëjnë me riprodhimin e zgjeruar të pyjeve,

— mban evidencën mbi gjendjen dhe shfrytëzimin e mjeteve për riprodhimin e zgjeruar të pyjeve,

merr iniciativën për sigurimin e mjeteve të solidaritetit për evitimin e pasojave nga fatkeqësitë elementare,

jep mendimin për propozimin për shpalljen e pyjeve mbrojtëse dhe pyjeve me destinim të posaçëm dhe jep mendimin për propozime të tjerëve për shpalljen e pyjeve mbrojtëse dhe të pyjeve me destinim të posaçëm,

kryen edhe punë dhe detyra tjera me interes të përgjithshëm për përparimin e pylltarisë.

Neni 88

Fondi e ka statutin.

Statutin dhe aktet tjera vetëqeverisëse të përgjithshme i nxjerr Kuvendi i Fondit.

Statutin e Fondit e vërteton Kuvendi i Krahinës socialiste Autonome të Kosovës.

Me statutin e Fondit më afërsisht rregullohen detyrat e Fondit, organizimi, organet dhe fushëveprimaria e punës së Fondit, numri i delegatëve dhe mënyra e delegimit të tyre në Kuvendin e Fondit, autorizimet dhe përgjegjësitë e Kuvendit dhe të organeve tjera të Fondit, mënyra e punës dhe vendosja në Kuvend dhe në organet tjera, mënyra e financimit të veprimtarisë së Fondit, si dhe çështjet tjera me interes të përbashkët për përparimin e pylltarisë.

Neni 89

Puna e Fondit dhe e organeve të tij është publike.

Fondi e informon Kuvendin e KSA të Kosovës dhe organet e tij për punën e vet.

Neni 90

Me punën e Fondit në pajtim me ligjin dhe statutin e Fondit qeverisë Kuvendi të cilin e përbëjnë delegatët:

Delegatët në Kuvendin e Fondit i delegojnë OPB të në lëmin e pylltarisë, OPB të industrisë së drurit, elektroekonomia, hidroekonomia dhe pronarët e pyjeve.

Në Kuvendin e Fondit nga një delegat e delegojnë Këshilli Ekzekutiv i Kuvendit të KSA të Kosovës, Konferenca Krahinore e LSPP, lidhja e malorëve dhe LRS e Kosovës.

Neni 91

Kuvendi i Fondit e ka organin ekzekutiv.

Me statutin e Fondit përcaktohet përbërja e organit Ekzekutiv numri dhe mënyra e zgjedhjes dhe e shkarkimit të anëtarëve të tij, si dhe kompetencat dhe përgjegjësitë e tij.

Neni 92

Kuvendi i Fondit ka sekretarin e vet.

Sekretarin e emëron dhe e shkarkon Kuvendin i Fondit.

Sekretari e përfaqëson Fondin dhe udhëheq me shërbimin profesional dhe i është përgjegjës për punën e vet Kuvendit të Fondit.

Kushtet të cilat duhet t'i plotësojë sekretari, procedura e zgjedhjes, të drejtat, obligimet dhe përgjegjësitë e sekretarit përcaktohen me statutin e Fondit.

Neni 93

Me statutin e Fondit përcaktohet numri i anëtarëve të kontrollit vetëqeverisëse dhe përbërja e tij, zgjedhja dhe shkarkimi anëtarëve mënyra e punës dhe vendosja, si dhe autorizimet dhe përgjegjësitë e organeve të kontrollimit vetëqeverisëse të Fondit.

Neni 94

Mjetet për punën e organeve dhe shërbimit profesional të Fondit sigurohen me planin vjetor financiar nga mjetet e Fondit.

Funët administrative profesionale për nevojat e Fondit, kryerja e disa punëve profesionale mund t'i besohet organizatës vetëqeverisëse ose bashkësisë e cila ka kuadër për kryerjen e atyre punëve.

Punëtorët e shërbimit profesional të Fondit e formojnë Bashkësinë punuese.

Neni 95

Mbikëqyrjen shoqërore të punës së Fondit e bënë Kuvendi i KSA të Kosovës.

X. INSPEKSIONI PYJOR

Neni 96

Mbikëqyrjen mbi zbatimin e dispozitave të këtij ligji dhe të dispozitave tjera në lëmin e pylltarisë dhe mbi zbatimin e masave që përcaktojnë organizatat që i qeverisin pyjet, e bëjnë organet e administratës kompetent për punët e inspeksionit pyjor (më tutje: inspeksioni pyjor).

Inspeksioni pyjor kryen mbikëqyrjen edhe mbi zbatimin e dispozitave mbi mbrojtjen e bimëve nga sëmurjet e bimëve dhe dëmtuesit në pyje dhe në fidanishtet pyjore.

Neni 97

Funët e inspeksionit pyjor në kuadër të të drejtave dhe detyrave të Krahinës i kryen organi krahinor i administratës kompetent për punët e pylltarisë, e në kuadër të të drejtave dhe detyrave të komunës, organet e administratës të caktuara me dispozitat komunale.

Neni 98

Funët e inspeksionit pyjor i kryejnë inspektorët e pylltarisë.

Inspektorët e pylltarisë i kryejnë punët e inspeksionit pyjor pavarësisht dhe veprojnë në kuadër të autorizimeve dhe detyrave të caktuara me këtë ligj dhe me dispozita tjera.

Neni 99

Në kryerjen e punëve të inspeksionit pyjor inspektori është i autorizuar dhe e ka për detyrë:

1. t'i kontrollojë të gjitha punët pyjore, objektet, pajisjet, veglat, si dhe të gjitha vendet ku kryhet prerja, vendosja, përpunimi dhe nxirren nga pylli apo lëshohen në qarkullim prodhimet pyjore,

2. të kontrollojë cilësinë e sortimenteve pyjore dhe të prodhimeve tjera pyjore,

3. të kontrollojë aplikimin dhe zbatimin e dispozitave të standartit jugosllavë nga lëmi i pylltarisë,

4. të kryejë mbikëqyrjen mbi zbatimin e dispozitave të bazës së përgjithshme ekonomike-pyjore dhe bazës ekonomike — pyjore të njësitë ekonomike, të planit vjetor të zhvillimit të punimeve të qeverisjes së pyjeve dhe programit të qeverisjes së pyjeve,

5. të kontrollojë se a janë harmonizuar reciprocisht bazat e përgjithshme ekonomike pyjore dhe bazat ekonomike-pyjore të njësitë ekonomike dhe planet vjetore të zhvillimit të punimeve të qeverisjes së pyjeve,

6. të kontrollojë librat afariste dhe dokumentet tjera atëherë kur kjo është e nevojshme me qëllim të kontrollit të aplikimit të dispozitave dhe masave që kanë të bëjnë me pyjet,

7. përkohësisht të ndalojë prerjet që nuk janë në pajtim me dispozitat e këtij ligji dhe dispozitat e nxjerra në bazë të tij, si dhe veprimet tjera të pa-

ligjshme gjer në vendbanimin përfundimtar të organit kompetent,

8. përkohësisht të marrë drunjtë e prerë pa leje dhe prodhime tjera pyjore të përyetësuar apo të prodhuara në mënyrë të paligjshme, si dhe sendet me të cilat janë kryer këto veprime të paligjshme,

9. që në rastet urgjente në të cilat kishte me u shkaktuar dëmi me interes të përgjithshëm të urdhërojë masat e përkohshme për pengimin e dëmit,

10. t'i njoftojë organet kompetente mbi padrejtësitë e vërejtura dhe të kërkojë intervenimin e tyre, në qoftë se vetë nuk është i autorizuar të veprojë drejtpërdrejt,

11. t'i mbledhë shënimet e nevojshme dhe njohimet nga personat përgjegjës, dëshmitarët dhe personat tjerë, kur kjo është e nevojshme.

12. të bëjë kontrollin se, uzinat në të cilat qytetarët e kryejnë përpunimin primar të drurit si veprimtari zejtare shërbyese, a i plotësojnë kushtet e përcaktuara,

13. t'i paraqesë fletëparaqitjet penale, fletëparaqitjet për deliktet ekonomike dhe kërkesat për hapjen e procedurës kundërvajtëse për veprat ndëshkimore të bëra në dëm të pyjeve,

14. të ndërrmarë masa e veprime tjera për të cilat është i autorizuar me dispozita të veçanta.

Prokurori kompetent publik e njofton inspektorin pyjor mbi përfundimin e procedurës sipas fletëparaqitjes penale, respektivisht mbi fletëparaqitjen për delikt ekonomik të cilin e ka paraqitur inspektori pyjor.

Neni 100

Organizatata, personat e tjerë juridikë, organet dhe qytetarët të të cilët bëhet kontrolli e kanë për detyrë që inspektorit pyjor t'ia mundësojnë kryerjen e inspektimit, t'i ofrojnë njohimet dhe të dhënat e nevojshme dhe t'ia lënë në disponim dokumentacionin e nevojshëm.

Neni 101

Inspeksioni pyjor komunal i kryen të gjithë punët e inspektimit pyjor, përveç atyre punëve që me këtë ligj janë lënë në kompetencën e organeve tjera.

Neni 102

Organi krahinor i administratës kompetent për punët e pylltarisë kujdeset mbi organizimin, përpunimin dhe kryerjen e drejtë të inspektimit pyjor në territorin e Krahinës, si dhe mbi përfeksionimin profesional të inspektorëve pyjorë dhe kryen mbikëqyrjen e drejtpërdrejtë mbi punën e inspeksionit pyjor dhe komunal në pikëpamje të zbatimit të dispozitave nga lëmi i pylltarisë dhe u ofron ndihmën profesionale.

Neni 103

Kur inspeksioni pyjor me rastin e kryerjes së mbikëqyrjes, konstaton se dispozita apo masa kurrësi nuk është aplikuar apo nuk është aplikuar në mënyrë të drejtë, me aktvendim urdhëron evitimin e tyre, si dhe afatin në të cilin organizata do ta njoftojë mbi evitimin e zbatuar të padrejtësive dhe mungesave.

Neni 104

Kundër aktvendimit të inspektorit pyjor mund të paraqitet ankesa në afatin prej 15 ditësh.

Ankesa kundër aktvendimit të inspektorit pyjor nuk ndalon ekzekutimin e aktvendimit.

Inspektori pyjor, kundër aktvendimit të të cilit është paraqitur ankesa, mundet në kërkesën e arsyetuar të paraqitësit të ankesës të shtyjë ekzekutimin e aktvendimit, në qoftëse se me ekzekutimin e tij shkaktohet dëmi, rrjedhimet e të cilit vështirë mund të evitohen.

Neni 105

Inspektor i pylltarisë i cili kryen punët e inspeksimit në kuadër të të drejtave dhe detyrave të Krahinës mund të emërohet personi që ka kryer Fakultetin e pylltarisë drejtimi i pylltarisë ose i përgjithshëm, provimin e dhënë profesional dhe që ka së paku 5 vjetë përvojë pune në ekonominë pyjore, kurse inspektor komunal i pylltarisë, personi që ka të kryer Fakultetin e pylltarisë (drejtimi i pylltarisë), provimin e dhënë profesional dhe më së paku 3 vjet përvojë pune në ekonominë pyjore.

Përfshatimisht nga dispozita e alinesë 1 të këtij neni në pyjet që i qeverisin pronarët, punët nga alinea 1 pika 1, 7, 8, 10, 11 dhe 12 të nenit 99 të këtij ligji mund t'i kryejnë edhe personat së pakut me pregatitje të ultë pylltarisë.

Neni 106

Inspeksioni pyjor duhet të ketë legjitimacionin me të cilin konstatohet përkatësia e tij e inspektorit pyjor.

XI. DISPOZITAT NDESHKIMORE

Neni 107

Organizata apo personi tjetër shoqëror ndëshkohet për deliktin ekonomik me ndëshkim në të holla prej 100.000 deri 1.000.000 dinarësh:

1. në qoftë se kryen apo lejon shkreterimin e pyllit, prerjen e pyllit apo prerjen e tërësishme të pyllit ose shet drunj të paprerë (neni 39 alinea 1), përveç kur kjo është e lejueshme (nenet 40, 41 dhe 42 alinea 1),

2. në qoftë se investuesi apo zhvilluesi i punimeve me rastin e ndërtimit të largpërçuesve apo objektit të ngjashëm në pyll cakton trasenë e largpërçuesit ose pret pyllin në mënyrë të kundërt me dispozitat e nenit 45 të këtij ligji.

Me ndëshkimin e përcaktuar në alinenë 1 të këtij neni ndëshkohet për deliktin ekonomik organizata:

1. në qoftë se nuk ka bazën e përgjithshme ekonomike-pyjore ose bazën ekonomike-pyjore të njësisë ekonomike, respektivisht planin e zhvillimit të punëve, respektivisht planin vejtör të qeverisjes së pyjeve (nenet 9 dhe 116),

2. në qoftë se mjetet e shpërbërimit nuk i shfrytëzon për qëllime të caktuara (neni 43 alinea 2),

3. në qoftë se gjer në afatin e caktuar nuk e kryen pyllëzimin (neni 50),

4. në qoftë se nuk ndërmerr masat me qëllim të mbrojtjes së pyllit nga zjarri apo fatkeqësitë tjera elementare, sëmundjet e bimëve, dëmtuesit ose dëmet tjera (neni 54).

Për deliktin ekonomik nga alinetë 1 dhe 2 të këtij neni ndëshkohet edhe personi përgjegjës në organizatë apo personi tjetër shoqëror-juridik me ndëshkim në të holla gjer 50.000 dinarë.

Në qoftë se me një nga veprimet nga alinetë 1 dhe 2 të këtij neni i janë shkaktuar veçanërisht rrjedhime të rënda, organizatës apo personit tjetër shoqëror-juridik mund t'i shqiptohet ndëshkimi gjer në pesëfishin e shumës së dëmit të bërë.

Neni 108

Organizatata apo personi tjetër shoqëror-juridik ndëshkohet për deliktin ekonomik me ndëshkim në të holla prej 70.000 gjer 700.000 dinarësh:

1. në qoftë se bënë qarkullimin e drurit i cili nuk është dëmkosur dhe për të cilin nuk është dhënë fletëpërcjellësja (neni 38 alinea 2),

2. në qoftë se bënë blerjen e asortimenteve pyjore të cilat nuk janë të dëmkosura dhe pa fletëpërcjellëse (neni 38 alinea 7),

3. në qoftë se kryen apo lejon prerjen e elementeve të farës apo të trungjeve të farës të cilat nuk

janë parashikuar në bazën ekonomike-pyjore (neni 39 alinea 1).

Me ndërkshkrimin e përcaktuar në alinenë 1 të këtij neni për deliktin ekonomik ndëshkohet organizata:

1. në qoftë se qeverisë pyjet në pronësinë shoqërore e nuk ka shërbimin e përcaktuar profesional (neni 19 alinea 2) apo shërbimin e ruajtjes së pyjeve (neni 57 alinea 2),

2. në qoftë se ua bartë pyjet organizatave tjera në kundërshtim me dispozitën e nenit 49 alinea 1 të këtij ligji,

3. në qoftë se në qeverisjen e pyjeve të shpallura për mbrojtje, respektivisht për pyll me destinim të veçantë nuk i ndërmerr masat e caktuara me aktin mbi shpalljen e pyllit për pyll mbrojtës, respektivisht për pyll me destinim të veçantë (neni 68 alinea 1),

4. në qoftë se nuk e bënë llogaritjen e mjeteve për riprodhimin e pyjeve (neni 76),

5. në qoftë se në afatin e caktuar nuk e nxjerrë bazën e përgjithshme ekonomike-pyjore apo bazën ekonomike-pyjore të njësisë ekonomike (neni 115).

Për deliktin ekonomik nga alinetë 1 dhe 2 të këtij neni ndëshkohet edhe personi përgjegjës në organizatë apo personi tjetër shoqëror-juridik me ndëshkim në të holla gjer 30.000 dinarë.

Neni 109

Organizata apo personi tjetër shoqëror-juridik ndëshkohet për kundërvajtje me ndëshkim në të holla prej 30.000 gjer 300.000 dinarësh:

1. në qoftë se bën apo lejon prerjen e pyllit pa shejimin paraprak (neni 35 alinea 1),

2. në qoftë se e heq nga vendi prerjen drurin që nuk është i dëmkosur (neni 38 alinea 1),

3. në qoftë se kullot bagëtinë apo lejon kullotjen, ushqimin e bagëtisë me lena (fryt lisash) ose prerjen e dushkut, grumbullimin e fletëve të terura dhe të myshkut ose bën veprime të tjera me të cilat dobësohet rritja e pyllit ose rrezikohet funksioni i pyllit (neni 39 alinea 1), përveç kur kjo është lejuar (neni 45 alinea 1),

4. në qoftë se bën ose lejon prerjen e trungjeve nga neni 44 alinea 1, ose këtë e bënë pa lejen e organit kompetent (neni 44 alinea 2),

5. në qoftë se si mbajtës i bagëtisë, në pyjet që mund të shfrytëzohen për kullotje, kullot bagëtinë pa lejen e organizatës që qeveris ato pyje ose me pëlqimin, por pa kontrollin e rojtarit të bagëtisë (neni 46 alinea 2),

6. në qoftë se bën shfrytëzimin e prodhimeve pyjore dhe prodhimeve tjera në kundërshtim me dispozitat e nenit 48 të këtij ligji,

7. në qoftë se ndezë zjarrin e hapur në pyllin ku kjo është e lejuar (neni 56 alinea 1), apo nuk u përmbahet kushteve dhe masave të përcaktuara të sigurisë me rastin e ndezjes së zjarrit të hapur në pyllin ku ndezja e zjarrit të hapur nuk është e lejuar (neni 56 alinea 2),

8. në qoftë se bën përpunimin primar të drurit që nuk është dëmkosur dhe për të cilin nuk është lëshuar fletëpërcjellësja (neni 64).

Me ndëshkimin e përcaktuar në alinenë 1 të këtij neni për kundërvajtje ndëshkohet organizata:

1) në qoftë se i zbaton dispozitat e bazës së përgjithshme ekonomike pyjore apo të bazës ekonomike-pyjore të njësisë ekonomike pa planin vjetor të zhvillimit të punëve të qeverisjes së pyjeve (neni 26 alinea 1),

2) në qoftë se punët në kultivimin e pyjeve nuk i kryen çdo vit proporcionalisht me vëlimin e prerjeve të bëra në vitin paraprak (neni 27 alinea 1),

3) në qoftë se nuk u përmbahet dispozitave të bazës së përgjithshme ekonomike-pyjore apo të bazës ekonomike-pyjore të njësisë ekonomike ose të planit vjetor të zhvillimit të punëve të qeverisjes së pyjeve (neni 28),

4) në qoftë se zgjedhjen e trungjeve për prerje e bën në kundërshtim me dispozitat e bazës së përgjithshme ekonomike-pyjore apo me bazat ekonomike pyjore të njësisë ekonomike (neni 35 alineja 2) ose nëpërmes të personave që nuk i plotësojnë kushtet e përcaktuara (neni 37),

5) në qoftë se në pyll kultivon egërsirat e llojit të atillë dhe në atë numër që pengojnë qeverisjen e drejtë të pyjeve (neni 51 alineja 1),

6) në qoftë se në afatin e caktuar nuk i përcakton masat për ruajtjen dhe vënien e rendit pyjor dhe nëse këto masa nuk i zbaton në mënyrën e përcaktuar dhe në afatin e caktuar (neni 55 alineja 4 dhe neni 123 pika 1),

7) në qoftë se nuk i përcakton kushtet nën të cilat mund ta ndizet zjarri i hapur në vendet e caktuara në pyll (neni 56 alineja 2),

8) në qoftë se pa leje prodhon pragje të gdhendur të hekurudhës (neni 65).

Për kundërvajtjen nga alinetë 1 dhe 2 të këtij neni ndëshkohet edhe personi përgjegjës në organizatë apo personi tjetër shoqëror-juridik me ndëshkim në të holla prej 3.000 gjer 20.000 dinarë.

Neni 110

Organizata apo personi tjetër shoqëror-juridik për kundërvajtje ndëshkohet me ndëshkim në të holla prej 10.000 gjer 100.000 din.

1. nëse për sasinë e prerë të drunjve nuk bënë vëllimin e paraparë të pyllëzimit (neni 27 alineja 2),

2. në qoftë se pengon inspektorin pyjor në kryerjen e inspeksionit apo nuk i ofron njohtime të nevojshme apo të dhëna ose i ofron njohtime dhe të dhëna të pasakta ose nuk ia lë në disponim dokumentacionin e nevojshëm (neni 100),

3. në qoftë se nuk vepron sipas aktvendimit të inspektorit pyjor (neni 103),

4. në qoftë se vepron në kundërshtim me dispozitat e nxjerrura në bazë të neneve 123, 124, dhe 125 të këtij ligji.

Me ndëshkimin e përcaktuar në alinenë 1 të këtij neni ndëshkohet për kundërvajtje organizata:

1. në qoftë se në bazën e përgjithshme ekonomike pyjore apo në bazën ekonomike pyjore të njësisë ekonomike ose në planin vjetor të zhvillimit të punëve qeverisjes së pyjeve nuk i evidenton punët e kryera (neni 31 alineja 1), ose nuk i evidenton në afatin e parashikuar (neni 31 alineja 2),

2. në qoftë se me sheja të dukshme mbi ndalimin e kullotjes nuk i shejon pyjet ku as përjashtimisht nuk lejohet kullotja e bagëtisë (neni 46 alineja 4),

3. në qoftë se nuk i cakton dhe nuk i shënon rrugët për grahjen e kafshëve në kullosë dhe në vendet për pirjen e ujit nëpër pyllin në të cilin kullotja nuk është e lejuar (neni 47 alineja 2),

4. në qoftë se nuk i paraqet kërkesën organit kompetent të organizatës për caktimin e kufijve të pyjeve që i qeverisë e që nuk janë caktuar (neni 70 alineja 1),

5. në qoftë se organit komunal të administratës së afatin e përcaktuar nuk ia dërgon të dhënat mbi pyjet që i qeverisë me qëllim të vënies së kadastrit të pyjeve ose nuk e njohton mbi ndryshimet e bëra (neni 73 alineja 2),

Për kundërvajtjen nga alinetë 1 dhe 2 këtij neni ndëshkohet edhe personi përgjegjës në organizatë apo personi tjetër shoqëror-juridik me ndëshkim në të holla prej 2.000 gjer 20.000 dinarë.

Neni 111

Me ndëshkim në të holla prej 9.000 gjer 50.000 dinarë për kundërvajtje ndëshkohet personi civil-juridik apo individ:

1. në qoftë se nuk u përmbahet dispozitave të programit të qeverisjes (neni 28),

2. në qoftë se kryen apo lejon prerjen e pyllit pa shejimin paraprak (neni 35 alineja 1),

3. në qoftë se bënë prerjen e pyllit jashtë kohës së caktuar (neni 36 dhe 118),

4. në qoftë se i heq nga vendi i prerjes drunjtë që nuk janë dëmkosur (neni 38 alineja 1),

5. në qoftë se në qarkullim drunjtë që nuk janë dëmkosur dhe për të cilët nuk është lëshuar fletëpërcjellsja (neni 38 alineja 2),

6. në qoftë se kryen apo lejon çilizimën apo prerjen e tërësishme të pyjeve kur kjo nuk është e lejueshme (neni 39 alineja 1),

7. në qoftë se kryen apo lejon kullotjen, ushqimin e kafshëve me lëndë prerjen e dushkut, grumbullimin e fletëve të terura dhe të myshkur apo bënë zbardhimin e trungjeve ose kryen prerjen e elementeve të farës apo të trungjeve të farës apo bënë veprime tjera me të cilat dobësohet rritje e pyllit apo rrezikohet funksioni i pyllit (neni 39 alineja 1),

8. në qoftë se bën ose lejon prerjen e trungjeve nga neni 44 alineja 1 të këtij ligji, ose këtë e bën pa lejen e organit kompetent (neni 44 alineja 2),

9. në qoftë se kryen kullotjen, respektivisht ushqimin e kafshëve me lëndë në pyllin ku është e lejueshme kullotja pa lejen e organizatës ose me leje, por pa mbikëqyrjen e rojtarit të kafshëve (neni 46 alineja 2),

10. në qoftë se dëmton ose shkaktron shenjat kufitare apo shenjat tjera të kufijve të pyjeve ose në qoftë se dëmton apo shkatërron shenjat pyjore mbi ndalimin e kullotjes (neni 46 alineja 4 dhe neni 70),

11. në qoftë se bën shfrytëzimin e prodhimeve pyjore dhe prodhimeve tjera në pyll dhe në tokën pyjore në kundërshtim me dispozitat e nenit 48 të këtij ligji,

12. në qoftë se gjer në afatin e caktuar nuk e kryen pyllëzimin e obligueshëm (neni 50),

13. në qoftë se pronari i pyllit nuk ndërmerr masa me qëllim të mbrojtjes së pyllit nga zjarri apo nga fatkeqësitë tjera elementare, sëmundjet e bimëve, dëmtuesit apo dëmet tjera (neni 54),

14. në qoftë se si pronar i pyllit nuk e mban apo nuk e vendos rendin pyjor në mënyrën apo në kohën e caktuar (neni 55 alineja 3),

15. në qoftë se ndez zjarrin e hapur në pyllin ku kjo nuk është e lejueshme (neni 56 alineja 1) apo nuk u përmbahet kushteve edhe masave të caktuara të sigurisë me rastin e ndezjes së zjarrit të hapur në pyllin ku kjo është e lejueshme (neni 56 alineja 2),

16. në qoftë se leviz nëpër pyll jashtë rrugëve publike me sopatë, sharrë apo me vegla të ngjashme pa leje (neni 61),

17. në qoftë se bën përpunimin primar të drurit në uzinet që nuk i plotësojnë kushtet e përcaktuara (neni 63 alineja 1, 2 dhe 3),

18. në qoftë se nuk mban librin e sharritjeve shërbyese (neni 63 alineja 4),

19. në qoftë se bën përpunimin primar të drurit që nuk është dëmkosur dhe për të cilin nuk është dhënë fletëpërcjellsja (neni 64 alineja 1),

20. në qoftë se prodhon pragje të gdhendura të ferovisë pa leje (neni 65),

21. në qoftë se në qeverisjen e pyllit të shpallur mbrojtjes respektivisht për pyll me destinim të veçantë (neni 68 alineja 1),

22. në qoftë se pengon inspektorin pyjor në kryerjen e inspeksionit apo nuk i ofron njohtimet ose shënime të pasakta ose nuk ia lë në disponim dokumentacionin e nevojshëm (neni 100),

23. në qoftë se nuk vepron sipas aktvendimit të inspektorit pyjor (neni 103),

24. në qoftë se me qëllim të vjedhjes rrëzon apo dëmton në pyll një ose më shumë trungje apo përvehtëson trungjet e rrëzuara, e sasia e drurit nuk është më e madhe se një metër kub,

25. në qoftë se bën prerjen e pyllit pa lejen ose në kundërshtim me lejen e organit komunal kompetent të administratës (neni 118),

26. në qoftë se vepron në kundërshtim me dispozitat e nxjerra në bazë të nenit 125 pika 2 të këtij ligji.

Në qoftë se kundërvajtja nga alineja 1 e këtij neni është kryer me qëllim të fitimit të dobisë materiale, kryesi i kundërvajtjes, do të dënohet me burg ose me ndëshkim në të holla prej 10.000 gjer 60.000 dinarë.

Për kundërvajtje nga pika 18 dhe 19 alineja 1 të këtij neni, kryesi, krahas me ndëshkimin në të holla, i shqiptohet masa mbrojtëse e marrjes së lejes për kryerjen e përpunimit primar të drurit si veprimtari zejtare shërbyese në zgjatjen prej një viti.

Për kundërvajtjen nga alineja 1 të pikës 24 të këtij neni, në rastin e përsëritur, mund të shqiptohet ndëshkimi me burg.

Neni 112

Prindi, respektivisht kujdestari të miturit ndëshkohet me ndëshkim në të holla prej 9.000 gjer 50.000 dinarë, në qoftë se ka lënë pas dore kujdesin mbi të miturin i cili ka bërë një nga kundërvajtjet nga neni 111 alineja 1 të këtij ligji.

Neni 113

Për delikt ekonomik nga neni 107 alineja 1 pika 1, neni 108 alineja 1 pika 1 dhe kundërvajtjen nga neni 109 alineja 1 pika 1, 2 dhe 8 të këtij ligji, përveç ndëshkimit në të holla, mund të shqiptohet edhe masa mbrojtëse e marrjes së pasurisë nga organizata apo personi tjetër shoqëror-juridik.

Për deliktin ekonomik nga neni 107 alineja 1 pika 1, neni 108 alineja 1 pika 1 dhe 2 dhe kundërvajtjen nga neni 109 alineja 1 pika 1, 2 dhe 3 të nenit 111 alineja 1 pika 2, 4, 5, 7, 11, 24 dhe 25 të këtij ligji, përveç dënimit mund të shqiptohet edhe masa mbrojtëse e marrjes së sendeve që janë përdorur ose kanë qenë të destinuara për kryerjen e deliktit ekonomik apo të kundërvajtjes ose janë siguruar me kryerjen e deliktit ekonomik, respektivisht të kundërvajtjes.

Sendet nga alineja 2 e këtij neni mund t'i marrë përkohësisht nga kryesi i deliktit ekonomik, respektivisht të kundërvajtjes, inspektori pyjor, punëtorët e milicisë dhe personat tjerë të autorizuar.

XII. DISPOZITAT KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 114

Organizatat ekzistuese të punës së bashkuar të pylltarisë të cilat qeverisin me pyjet në pronësinë shoqërore, rajon të ekzistuese ekonomike pyjore dhe me pyjet jashtë rajoneve ekonomike-pyjore janë të obliguara që në afat prej një viti nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji, të bashkohen në organizatat punuese të pylltarisë në kuadër të rajoneve ekonomike-pyjore të formuara nga neni 15 të këtij ligji dhe t'i harmonizojnë aktet e veta vzetëqeverisëse e me dispozitat e këtij ligji.

Pas kalimit të afatit nga paragrafi 1 të këtij neni u ndërprehet e drejta e qeverisjes me pyjet në pronësinë shoqërore organizatave të punës së bashkuar të cilat nuk e zbatojnë procedurën e bashkimit sipas dispozitave të këtij neni.

Neni 115

Për pyjet për të cilat nuk janë nxjerrë bazat ekonomike-pyjore të njësisë ekonomike, të njejtat duhet të nxirret përfundimisht gjer në fund të vitit 1990.

Në afatin nga paragrafi 1 të këtij neni organizatat janë të obliguara të nxjerrin bazat ekonomike-pyjore për çdo vit më së paku për një të katërtën e sipërfaqes së pyjeve të parregulluara.

Neni 116

Pyjet në pronësinë shoqërore, për të cilat nuk është nxjerrë baza ekonomike-pyjore sipas dispozitave të gjertanishme, si dhe baza ekonomike-pyjore e njësisë ekonomike, qeverisin në bazë të planit vjetor të qeverisjes së pyjeve në pronësinë shoqërore.

Dispozitat e këtij ligji mbi evidencën e punëve të kryera gjatë vitit (neni 31 alineja 1 dhe 2), kohën e prerjes (neni 36 alineja 2), zgjedhjen e trunjeve për prerje (neni 35 alineja 2), si dhe dispozitat ndëshkimore për shkeljen e këtyre dispozitave (neni 109 alineja 2 pika 4 dhe neni 110 alineja 2 pika 1), që kanë të bëjnë me bazat ekonomike-pyjore, aplikohen edhe në planet vjetore të qeverisjes së pyjeve.

Neni 117

Planin vjetor të qeverisjes së pyjeve në pronësinë shoqërore e nxjerr organizata që qeveris pyjet e komunës në territorin e së cilës gjenden pyjet.

Këshilli ekzekutiv i kuvendi të komunës e ka për detyrë që në afatin prej 45 ditësh, nga dita e marrjes së planit vjetor të qeverisjes së pyjeve për vërtetimin të nxjerrë Aktvendimin mbi dhënien apo refuzimin e vërtetimit.

Në qoftë se këshilli ekzekutiv nga alineja 1 e këtij neni, në afatin nga alineja 2 e këtij neni, nuk nxjerr aktvendimin, konsiderohet se e ka vërtetuar planin vjetor të qeverisjes së pyjeve.

Neni 118

Gjer në nxjerrjen e programit të qeverisjes së pyjeve që qeverisin pronarët, prerja e pyjeve bëhet në bazë të lejes të organit komunal të administratës kompetente e pylltarisë dhe shejmit të bërë. Me këtë leje caktohet edhe koha e prerjes.

Me lejen nga alineja 1 e këtij neni mund të lejohet edhe prerja e tërësishme e pyllit, në qoftë se kjo prerje është formë e rregullt e përtërirjes së pyllit.

Ekzekutimi i lejes për prerjen e pyllit nga alineja 1 dhe 2 të këtij neni, në bazë të vendimit të kuvendit të komunës, mund të kushtëzohet me obligimin e pronarit të pyllit të bëjë punët e caktuara të mirëmbajtjes, përtërirjes dhe rikonstruktimit të pyjeve, proporcionalisht vëllimit të prerjes së lejuar.

Me këtë aktvendim caktohet vendi, afati dhe mënyra e kryerjes së punëve.

Neni 119

Gjer në nxjerrjen e Programit të qeverisjes së pyjeve për punët që i qeverisin pronarët, kuvendi i komunës mund të vendos që këto pyje të qeverisin në bazë të planit vjetor të qeverisjes së pyjeve.

Me vendimin nga alineja 1 e këtij neni kuvendi i komunës përcakton përmëbajtjen, mënyrën e hartimit dhe të zbatimit të planit vjetor të qeverisjes së pyjeve.

Neni 120

Kufijtë e pyjeve në pronësinë shoqërore që nuk janë përcaktuar, përcaktohen më së largu gjer në fund të vitit 1990.

Neni 121

Bazat ekonomike pyjore, të nxjerrura në bazë të dispozitave të gjertanishme vlen gjersa të skadojë afati për të cilin janë nxjerrë.

Neni 122

Organizatat dhe personat e tjerë shoqëror-juridikë që i qeverisin pyjet e kanë për detyrë që në

afatin prej 6 muajsh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji të përcaktojnë:

- 1) masat për mbajtjen dhe vënien e rendit pyjor dhe mënyrën e kohën e zbatimit të këtyre masave pyjet që i qeverisin (neni 55 alineja 4),
- 2) të drejtat dhe detyrat e rojtarëve të pyjeve në kryerjen e shërbimit të ruajtjes së pyjeve (neni 57 alineja 2).

Neni 123

Sekretariati Krahinor i Ekonomisë dispozitën nga neni 63 alineja 5 të këtij ligji do ta nxjerrë brenda afatit prej një vit nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 124

Organi Krahinor i administratës kompetent për punët e pylltarisë në afatin prej një viti nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji, do të nxjerrë dispozitat më të hollësishme:

1. Mbi mënyrën e hartimit të bazës së përgjithshme ekonomike-pyjore, bazat ekonomike-pyjore të njësisë ekonomike dhe planet vjetore të zhvillimit të punëve të qeverisjes së pyjeve në pronësinë shoqërore,
2. mbi mënyrën e hartimit të programit të qeverisjes së pyjeve për pyjet që nuk i qeverisin organizatat e punës së bashkuar,
3. mbi formën dhe përmbajtjen e legjitimacionit të rojtarëve të pyjeve,
4. mbi qepjen dhe shenjen e rrobave zyrtare (uniforma) të rojtarit të pyllit,
5. mbi përmbajtjen dhe mënyrën e hartimit të planit vjetor të ekonomizimit të pyjeve me të cilat ekonomizon organizatat e punës së bashkuar,
6. mbi masat të cilat janë të obliguara t'i zbatojnë pronarët e pyjeve me qëllim të mirëmbajtjes dhe vënies së rendit pyjor dhe mbi mënyrën dhe kohën e zbatimit të tyre,
7. mbi mënyrën e shënimit dhe evidencimit të trungjeve për prerje, mbi formën e dëmkës, mënyrën dhe vëllimin e dëmkosjes, si dhe mbi formularin e librit të dëmkosjeve dhe certifikatës mbi prejardhjen e drurit,
8. mbi formën dhe përmbajtjen e legjitimacionit të inspektorit të pylltarisë,
9. mbi përmbajtjen e dokumentacionit ekonomiko-teknik për formimin e rajoneve ekonomiko-pyjore dhe mbi mënyrën e dorëzimit të rajoneve në shfrytëzim organizatave të punës së bashkuar.

Neni 125

Gjer në nxjerrjen e dispozitave në bazë të autorizimeve nga ky ligj, do të aplikohen, në qoftë se nuk janë në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji:

1. Dekreti mbi mënyrën e vënies dhe udhëheqjes së kadastrit të pyjeve („Gazeta zyrtare e KSAK”, nr. 13/74),
2. Vendimi mbi ndarjen e pyjeve dhe të kompleksit të tokës pyjore „Doboçek” nga rajoni ekonomik pyjor „Mokra-Gora” dhe bartjen e të drejtave të qeverisjes në Ekonominë Krahinore të Gjuetisë („Gazeta zyrtare e KSAK”, nr. 49/75),
3. Rregullorja mbi përmbajtjen dhe mënyrën e hartimit të planeve vjetore të qeverisjes së pyjeve të cilat i qeverisin organizatat e punës së bashkuar („Gazeta zyrtare e KSAK”, nr. 37/74),
4. Rregullorja mbi masat që kanë për detyrë t'i zbatojnë pronarët e pyjeve me qëllim të ruajtjes dhe vënies së rendit pyjor si dhe mbi mënyrën e kohës e zbatimit të tyre („Gazeta zyrtare e KSAK”, nr. 13/74),
5. Rregullorja mbi mënyrën e shënjimit dhe evidencimit të trungjeve për prerje, formën e dëmkës, mënyrën dhe vëllimin e dëmkosjes, si dhe mbi formularin e librit të shënjimeve dhe certifikatave mbi prejardhjen e drurit („Gazeta zyrtare e KSAK”, nr. 37/74),

6. Rregullorja mbi formën dhe përmbajtjen e legjitimacionit të inspektorit pyjor („Gazeta zyrtare e KSAK”, nr. 18/74),

7. Rregullorja mbi qepjen dhe shenjat e rrobave zyrtare (uniformën) të rojtarëve të pyjeve („Gazeta zyrtare e KSAK”, nr. 50/75),

8. Rregullorja mbi kushtet tjera që duhet t'i plotësojnë uzinat për përpunimin primar të drurit që e kryejnë qytetarët si veprimtari zyrtarë shërbyese dhe mbi librin e sharritjeve shërbyese („Gazeta zyrtare e KSAK”, nr. 13/74),

9. Udhëzimi mbi përmbajtjen e dokumentacionit ekonomiko-teknik për formimin e rajoneve ekonomike pyjore dhe mbi mënyrën e dorëzimit të rajoneve në shfrytëzim të organizatave të caktuara të punës së bashkuar („Gazeta zyrtare e KSAK”, nr. 13/74).

Neni 126

Dispozitën nga neni 82 alineja 2 e këtij ligji do ta nxjerrë Këshilli Ekzekutiv i Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës mbrenda afatit prej një viti, nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

REGJISTRIMI I PYJEVE DHE I TOKAVE PYJORE TË PËRFSHIRA NË RAJONET EKONOMIKO-PYJORE

I. RAJONI EKONOMIKO-PYJOR I ANAMORAVËS

Rajonin ekonomik-pyjor të anamoravës e përbëjnë pyjet dhe tokat pyjore në sipërfaqe prej 66.389 ha.

1. Pyjet dhe toka pyjore në pronësinë shoqërore me të cilat qeverisin organizatat e punës së bashkuar në lëmin e pylltarisë në territorin e komunave Gjilan, Kamenicë dhe Viti, në sipërfaqe prej 43.305 ha.
2. Pyjet në të cilat ekziston e drejta e pronësisë në territorin e komunave Gjilan, Kamenicë dhe Viti, në sipërfaqe prej 23.084 ha.

II. RAJONI EKONOMIKO-PYJOR I NERODIMLËS — LEPENCIT

Rajonin ekonomik-pyjor të Nerodimlës — Lepencit e përbëjnë pyjet dhe toka pyjore, në sipërfaqe prej 48.025 ha.

1. Pyjet dhe toka pyjore në pronësinë shoqërore me të cilat qeverisin organizatat e punës së bashkuar në lëmin e pylltarisë në territorin e komunave Kaçanik dhe Ferizaj, në sipërfaqe prej 36.060 ha.
2. Pyjet në të cilat ekziston e drejta e pronësisë në territorin e komunave Kaçanik dhe Ferizaj, në sipërfaqe prej 11.965 ha.

III. RAJONI EKONOMIKO-PYJOR I SHARRIT — PODRIMËS

Rajonin ekonomik-pyjor të Sharrit-Podrimës e përbëjnë pyjet dhe toka pyjore në sipërfaqe të gjithëmbarshme prej 75.347 ha.

1. Pyjet dhe toka pyjore në pronësinë shoqërore me të cilat qeverisin organizatat e punës së bashkuar në lëmin e pylltarisë në territorin e komunave Dragash, Rahovec, Prizren dhe Suharekë, në sipërfaqe prej 53.040 ha.
2. Pyjet në të cilat ekziston e drejta e pronësisë në territorin e komunave Dragash, Rahovec, Prizren dhe Suharekë, në sipërfaqe prej 22.307 ha.

IV. RAJONI EKONOMIKO-PYJOR I MALEVE TË NEMUNA — BISTRICËS

Rajonin ekonomik-pyjor të Maleve të Nemuna — Bistricës e përbëjnë pyjet dhe toka pyjore në sipërfaqe prej 103.550 ha.

1. Pyjet dhe toka pyjore në pronësinë shoqërore me të cilat qeverisin organizatat e punës së bashkuar në lëmin e pylltarisë në territorin e komunave

ve Deçan, Gjakovë, Istog, Klinë dhe Pejë, në sipërfaqe prej 72.025 ha.

2. Pyjet në të cilat ekziston e drejta e pronësisë në territorin e komunave Deçan, Gjakovë, Istog, Klinë dhe Pejë, në sipërfaqe prej 31.525 ha.

V. RAJONI EKONOMIKO-PYJOR IBËR — LLAP

Rajonin ekonomiko-pyJOR Ibër — Llap e përbëjnë pyjet dhe toka pyjore në sipërfaqe prej 107.236 ha.

1. Pyjet dhe toka pyjore në pronësinë shoqërore me të cilat qeverisin organizatat e punës së bashkuar në lëmin e pylltarisë në territorin e komunave Leposaviq, Podujevë dhe Mitrovicë e Titos, në sipërfaqe prej 75.582 ha.

2. Pyjet në të cilat ekziston e drejta e pronësisë në territorin e komunave Leposaviq, Padujevë, Mitrovicë e Titos, në sipërfaqe prej 34.664 ha.

VI. RAJONI I KOSOVËS — DRENICËS I PYJEVE TË ULTA TË DEGRADUARA

Rajonin e Kosovës — Drenicës të pyjeve të ulta të degraduara e përbëjnë pyjet dhe toka pyjore në sipërfaqe prej 80.673 ha.

1. Pyjet dhe toka pyjore në pronësinë shoqërore me të cilat qeverisin organizatat e punës së bashkuar në lëmin e pylltarisë në territorin e komunave Vuçiternë, Glogovc, Lipjan, Prishtinë, dhe Serbicë, në sipërfaqe prej 41.470 ha.

2. Pyjet në të cilat ekziston e drejta e pronësisë në territorin e komunave Vuçiternë, Glogovc, Lipjan, Prishtinë dhe Serbicë, në sipërfaqe prej 39.203 ha.